



BASHKIA E TIRANËS

**Dokumentacioni i Tenderit të Konkensionit
/ Partneritetit Publik Privat
për Hartimin, Ndërtimin, Financimin,
Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin
e
Terminalit të Transportit Publik
Tiranë**





TABELA E LËNDËS

| | | |
|--------------|--|----|
| SEKSIONI I | Autoriteti Kontraktor | 7 |
| SEKSIONI II | Objekti i kontratës | 8 |
| SEKSIONI III | Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik..... | 10 |
| SEKSIONI IV | Procedura..... | 11 |
| SEKSIONI V | Informacione Plotësuese..... | 13 |
| SEKSIONI VI | Shtojcat | 36 |





NJOFTIM I PROCEDURËS SË TENDERIT





SEKSIONI I Autoriteti Kontraktor

I.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Bashkia e Tiranës
 Adresa: Bulevardi “Deshmoret e Kombit”
 Tel/Fax: 00 355 4 22 56 799
 E-mail: prokurimet@tirana.gov.al
 Faqja e Internetit: www.tirana.gov.al

I.2 Emri dhe adresa e personit të kontaktit

Emri: Z. Genc Kojdheli
 Adresa: Bulevardi Deshmoret e Kombit,
 Tel:
 Faks:
 E-mail: genc.kojdheli@tirana.al

I.3 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore

| | |
|---|---|
| Institucion qëndror <input type="checkbox"/> | Institucion i pavarur <input type="checkbox"/> |
| Njësi e Qeverisjes Vendore <input checked="" type="checkbox"/> | Tjetër <input type="checkbox"/> |



SEKSIONI II Objekti i kontratës

II.1 Lloji i kontratës

| | |
|---|--------------------------------------|
| Punë <input checked="" type="checkbox"/> | Shërbime <input type="checkbox"/> |
|---|--------------------------------------|

II.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së koncensionit/partneritetit publik privat

II.2.1 Objekti i Kontratës:

Bashkia e Tiranës ose "**Autoriteti Kontraktor**", fton Operatorët Ekonomikë në një procedurë ndërkombëtare tenderimi për Partneritetin Publik Privat për hartimin e detajuar dhe zbatimin e ndërtimit të një terminali të ri të transportit publik, mirëmbajtjen e tij të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, si dhe menaxhimin e mëvonshëm të terminalit të transportit publik të Tiranës ("**Projekti**") siç përcaktohet në *Shtojcën 14 Termat e Referencës*, në përputhje me procedurat dhe kushtet e përcaktuara në këto dokumente tenderi dhe me kushtet e kontratës të dhëna në *Shtojcën 17 Kushtet e Përgjithshme të Kontratës* dhe *Shtojcën 18 Kushtet e Veçanta të Kontratës*. Vlera e vlerësuar e projektit është 15.5 milionë Euro. Autoriteti Kontraktor do të zbatojë procedurën e hapur të tenderit në pajtim me nenin 22 të ligjit shqiptar të koncesioneve dhe partneritetit publik privat nr. 125/2013. Autoriteti kontraktor do të marrë parasysh vetëm ofertat e atyre tenderuesve apo konsorciumet e tenderuesve, të cilët kanë kaluar kufijtë minimalë, të përcaktuara në kriteret e kualifikimit (*Shtojca 9 Dëshmi Kualifikimi / Formularin e Pjesëmarrjes*).

Gjatë ndërtimit të terminalit, objektivi i Autoritetit Kontraktor është përmirësimi i lëvizshmërisë së përgjithshme, duke siguruar një terminal me kapacitet të plotë transporti ku autobusët ndërqytetës do të shkarkojnë pasagjerë për në autobusë urbane dhe taksi përgjatë korridorit kryesor të qytetit në pjesën veriore, perëndimore dhe jugore të vendit, duke zvogëluar bllokimet e trafikut në qendër të qytetit, përmirësimin e ndotjes së ajrit dhe reduktimin e konsumit të karburantit për transport publik.

Autoriteti Kontraktor do të ofrojë një truall prej 85,000 metra katrorë vendosur përgjatë korridorit kryesor që çon në veri-perëndim, nga qyteti në drejtim të Durrësit, truall i cili do t'i kontraktohet në baza afatgjatë Ofertuesit fitues për të ndërtuar, operuar dhe për të ruajtur terminalin për të mirën e operatorëve dhe udhëtarëve. Në shkëmbim, të gjitha tarifat e vendqendrimit të autobusëve, të ardhurat e qiradhënies me pakicë, dhe tarifat e parkimit, do të arkëtohen nga Operatori Ekonomik për amortizimin e CAPEX-it të tij fillestar, shpenzimet operative, dhe për mbulimin e shërbimit të borxhit.

Kontrata do të jepet përmes një procesi konkurrues ndërkombëtar ofertimi, duke ndjekur procedurën e përshkruar në këtë Dokument Ofertues.



Tenderimi për kontratën është i hapur për firmat dhe sipërmarrjet e përbashkëta të firmave e çdo vendi të cilat plotësojnë kushtet dhe kriteret e parashikuara në *Shtojcën 9 Dëshmi Kualifikimi/ Formulari i Pjesëmarrjes*.

II.2.2 Forma e kontratës

Kontratë Partneriteti Publik Privat për koncesionin e punëve publike.

II.2.3 Burimi i Financimit

Sektor Privat

II.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin e saj

Kohëzgjatja e kontratës PPP të Koncesionit do të jetë ajo e ofruar nga Ofertuesi fitues (ndërmjet 15 dhe 35 vitesh).

II.4 Vendodhja e objektit të kontratës

Ky projekt ndodhet në Tiranë.




SEKSIONI III Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

III.1 Kriteret e pranimit

Kriteret e pranimit të ofertave janë sipas *Shtojcës 9 Dëshmi Kualifikimi/ Formulari i Pjesëmarrjes*.

III.2 Sigurimi i Ofertës

Operatori Ekonomik që merr pjesë në këtë procedurë Koncesioni/Partneriteti Publik Privat, duhet të dorëzojë sëbashku me ofertën e tij një Siguri Oferte të barabartë me 2% të vlerës së parashikuar të projektit (siç jepet në *IV.1.1 Vlera Totale*) në formularin e përcaktuar në **Error! Reference source not found.** *Formulari i Sigurimit të Ofertës*.





SEKSIONI IV Procedura

IV.1 Lloji i procedurës

| | | |
|--|--|---|
| E Hapur <input checked="" type="checkbox"/> | E Kufizuar <input type="checkbox"/> | Me negociim me shpallje paraprake <input type="checkbox"/> |
|--|--|---|

IV.1.1 Vlera Totale

Vlera e vlerësuar e projektit është 15.477.857,31 Euro (pa përfshirë TVSH)

Monedha: Euro

Vlera e parashikuar në këtë paragraf është shuma e llogaritur si investimi total filles-tar i kërkuar.

IV.2 Kriteret për përzgjedhjen e fituesve

Kriteret për përzgjedhjen e ofertuesve fitues janë ato të përcaktuara në *Shtojca 11* Kriteret e Vlerësimit.

IV.3 Afati kohor për dorëzimin e ofertave

Datë: 07.11.2016

Ora: 12:00

Vendi: www.app.gov.al

Ofertuesit duhet të dorëzojnë ofertën e tyre me mjete elektronike. Operatorët ekonomikë e dorëzojnë ofertën e tyre elektronikisht në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik Shqiptar, www.app.gov.al

IV.4 Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje

Datë: 07.11.2016

Ora: 12:00

Vendi: www.app.gov.al

Informacioni i komunikuar gjatë hapjes publike të ofertave, të paraqitura me mjete elektronike, duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar oferta, në bazë të kërkesës së tyre



IV.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave

Periudha e vlefshmërisë së ofertave është njëqind e pesëdhjetë (150) ditë.

IV.6 Gjuhët për hartimin e kërkesave për pjesëmarrje

Ofertat mund të dorëzohen në gjuhën Angleze ose Shqipe.

IV.7 Monedha

Ofruesi përdor monedhën EURO (€)

Për konvertimin e monedhave të tjera do të përdoret kursi zyrtar i këmbimit në ditën e publikimit të këtij njoftimi.





SEKSIONI V Informacione plotësuese

V.1 Dokumentat me Pagesë

| Po | Jo |
|--------------------------|-------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> | <input checked="" type="checkbox"/> |

Nëse Po

Monedha Lek Shqiptare (ALL) Çmimi _____

Ky çmim përfshin kopjimin aktual dhe shpërndarjen e Dokumenteve Standarde të Konkensionit / Partneritetit Publik Privat për Operatorët Ekonomikë. Operatorët Ekonomikë të interesuar kanë të drejtë të kontrollojnë dokumentet Standarde të Konkensionit / Partneritetit Publik Privat para blerjes.

V.2 Informacione shtesë (vendi, zyra, mënyrat për tërheqjen e dokumentave të tenderit)

Ky dokument mund të gjendet në faqen e internetit www.app.gov.al

"Përshkrimi i projektit" dhe "Projekt Kontrata e Konkensionit / Partneritetit Publik Privat" mund të merren në adresën e autoritetit kontraktor siç specifikohet në SEKSIONIN I par. I.2 në kohën që do të përcaktohet dhe pas paraqitjes së një kopje të marrëveshjes së konfidencialitetit (Shtojca 34) të nënshkruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ofertuesit të ardhshëm.

Data e shpërndarjes së këtij njoftimi:

16.09.2016



Formularët e Ofertës Financiare

Shtojca 33 Formulari i Ofertës Financiare (Formulari 18)

Shtojca 34 Formulari i Afatit të Ndërtimit (Formulari 19)

Kushtet e Draft Kontratës

Dokumentet e mëposhtme përbëjnë kushtet e draft kontratës:

- "Draft Kontrata e Konkensionit / Partneritetit Publik Privat" duke përfshirë formularët e kontratës së Konkensionit / Partneritetit Publik Privat dhe garancisë financiare të Bankës. Ky është një dokument i veçantë që mund të merret siç përshkruhet në SEKSIONIN V par. V.2.
- Formulari i Sigurimit të Performancës (Shtojca 19)

Kërkesat e Projektit

Dokumentet e mëposhtme përbëjnë kërkesat e projektit:

- Përshkrimi i projektit ("**Përshkrimi i Projektit**") është një dokument i veçantë që mund të merret siç përshkruhet në SEKSIONIN V par. V.2.
- Kriteret minimale teknike (Shtojca 13)
- Termat e Referencës (Shtojca 14)

1.1.1 Ofertuesi pritët të shqyrtojë të gjitha udhëzimet, formularët, kushtet, specifikimet dhe informacionet e tjera në dokumentet e tenderit. Pamundësia për të dhënë të gjithë informacionin e kërkuar nga dokumentet e tenderit ose dorëzimi i një oferte jo të përgjegjshme në dokumentet e tenderit në çdo aspekt do të jetë në rrezik të Ofertuesit dhe mund të rezultojë në refuzimin e ofertës së tij.

1.2 Sqarimi i Dokumenteve të Tenderit

1.2.1 Një ofertues i ardhshëm që kërkon sqarime për aspekte të dokumenteve të tenderit mund të njoftojë Autoritetin Kontraktor me shkrim nëpërmjet e-mail-it në adresën elektronike të Autoritetit Kontraktor të specifikuar në *SEKSIONIN I paragrafi 1.2, Emri dhe adresa e personit përgjegjës*. Të gjitha kërkesat për sqarime duhet të pranohen nga Autoriteti Kontraktor jo më vonë se pesë (5) ditë para skadimit të afatit për dorëzimin e ofertave. Autoriteti Kontraktor do të përgjigjet ndaj kërkesave të tilla për sqarim të dokumenteve të tenderit, të cilat ai i merr. Përgjigjet me shkrim të Autoritetit Kontraktor (duke përfshirë një përshkrim të hetimit, por pa



identifikuar burimin e tij) do të publikohen në faqen e internetit www.app.gov.al.

- 1.2.2 Asnjë përgjigje për sqarime dhe / ose informacion të dhënë qoftë me gojë ose me shkrim nuk do të jetë detyruese mbi palët. Vetëm Kontrata e Konkensionit/ Partneritetit Publik Privat dhe shtojcat e saj, kur të ekzekutohen siç duhet, do të jetë detyruese për palët.

1.3 Ndryshime në Dokumentet e Tenderit

3.3.1 Në çdo kohë para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, Autoriteti Kontraktor mund, për çfarëdo arsye, qoftë me nismën e vet ose, në përgjigje të një sqarimi të kërkuar nga një ofertues, të ndryshojë dokumentet e tenderit duke nxjerrë shtesa të tyre.

3.3.2 Shtojcat e lëshuara në këtë mënyrë duhet të jenë pjesë e dokumenteve të tenderit dhe do të publikohen në faqen e internetit www.app.gov.al. Ofertuesi ka detyrimin të verifikojë në faqen e internetit çdo ndryshim në dokumentet e tenderit. Do të supozohet se informatat e publikuara do të jenë marrë parasysh nga ofertuesi në ofertën e tij.

3.3.3 Për ti dhënë ofertuesve të mundshëm kohë të arsyeshme në të cilën të marrin parasysh ndryshimin në përgatitjen e ofertës së tyre, Autoriteti Kontraktor mund, në diskrecionin e tij, të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e ofertave, siç parashikohet në paragrafin 5.2.2.

3.4 Informacioni i siguar nga Autoriteti Kontraktor / Kontroll i detajuar i Ofertuesit

3.4.1 Secili Ofertues është përgjegjës vetëm për kryerjen e kërimit të tij të pavarur, kontrollit të detajuar, ndonjë pune tjetër ose hetimi dhe për të kërkuar ndonjë këshillë tjetër të pavarur të nevojshme për përgatitjen e ofertës, negocimit të marrëveshjeve, dhe shpërndarjes pasuese të të gjithë shërbimeve të ofruara nga Ofertuesi i Suksesshëm.

3.4.2 Nuk është bërë asnjë përfaqësim ose garanci, e shprehur apo e nënkuptuar, dhe asnjë Përgjegjësi e ndonjë lloji nuk është pranuar nga Autoriteti Kontraktor apo këshilltarët e tij, punonjësit apo agjentët, konsulentët, për plotësinë apo saktësinë e informacionit në përmbajtje të dokumenteve të tenderit ose Përgjigje ndaj Dokumenteve Pyetësore, apo të siguruara gjatë procesit të tenderit ose gjatë afatit të kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, të jetë përgjegjëse për ndonjë person ose subjekt, si pasojë e përdorimit të informacionit të përmbajtur në dokumentet e tenderit ose në përgjigje të dokumenteve pyetësore, ose të ofruara gjatë procesit të tenderit apo gjatë afatit të kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.



- 3.4.3 Ofertuesit nuk do të mbështeten në deklaratat gojore të bëra nga Autoriteti Kontraktor apo këshilltarët, të punësuarit, konsulentët ose agjentët e tij.
- 3.4.4 Të gjithë Ofertuesit duhet, para dorëzimit të ofertës së tyre, të shqyrtojnë të gjitha kërkesat në lidhje me regjistrimin korporativ dhe të gjitha kërkesat e tjera të zbatueshme për kompanitë që dëshirojnë të kryejnë biznes në Shqipëri. Ofertuesit janë përgjegjës për të gjitha çështjet që lidhen me kapacitetin e tyre ligjor për të vepruar në juridiksionin në të cilën ky Proces Tenderi zbatohet.
- 3.3.5 Informacioni (siç përcaktohet në Marrëveshjen e Konfidencialitetit dhënë në *Shtojcën 34*) i ofruar nga Autoriteti Kontraktor, do të jetë subjekt i Marrëveshjes së Konfidencialitetit të nënshkruar rregullisht nga të gjithë Ofertuesit.

2 Përgatitja e Ofertave

2.1 Gjuha e Ofertës

- 2.1.1 Oferta dhe të gjithë dokumentet dhe korrespondenca që lidhet me të duhet të jenë në gjuhën e ofertës të specifikuar në të *SEKSIONIN IV paragrafi IV.6 Gjuhët për hartimin e kërkesave për pjesëmarrje*. Dokumentet e shtypura, të ofruara nga ofertuesi mund të jenë të shkruara në një gjuhë tjetër për aq kohë sa një literaturë e tillë shoqërohet me një përkthim të saktë të paragrafëve të saj përkatës në gjuhën e ofertës, rast në të cilin, për qëllime të interpretimit të ofertës, përkthimi do të mbizotërojë.

2.2 Dokumentet që përbëjnë tenderin

- 4.2.1 Informacioni do të dorëzohet në formatet e specifikuar në formularët e këtyre Dokumenteve të Tenderit. Oferta e dorëzuar në përputhje me këto Udhëzime për Ofertuesit përbëhet si më poshtë:
- (a) Dokumentacioni i kualifikimit i përbërë nga dokumentet e mëposhtme (kolektivisht, "**Dokumentacioni Administrativ**"):
- (1) Formulari i Aplikimit të Ofertës (në formatin e treguar në *Shtojcën 1*) i plotësuar rregullisht në mënyrën dhe detajet e treguara në të dhe nënshkruar nga ofertuesi;
 - (2) Sigurimi i Ofertës, dhënë në përputhje me *Shtojcën 3*;
 - (3) Prokura e Posaçme (në formatin e treguar në *Shtojcën 22 Prokura e Posaçme* (Formulari 1))



- (4) Pranueshmëria e Ofertuesve dhe Kualifikimet e kërkuara sipas Shtojcës 9 *Dëshmi të Kualifikimeve / Formulari i Pjesëmarrjes*, duke përdorur Formularin e Pranueshmërisë dhe Kualifikimeve:
- i. Informacion i Përgjithshëm (Formulari 2)
 - ii. Deklarata për statusin ligjor (Formulari 3)
 - iii. Deklarata e plotësimit të kërkesave të dokumenteve standarde të Koncensionit / partneritetit publik privat (Formulari 4)
 - iv. Deklarata për konfliktin e interesave (Formulari 5)
 - v. Dokumentet e Përgjithshme të Kualifikimit (Formulari 6)
 - vi. Aftësia Financiare (Formulari 7)
 - vii. Eksperiencia e Përgjithshme në Ndërtim (Formulari 8)
 - viii. Eksperiencia e Përgjithshme në Ndërtime Rrugore (Formulari 9)
 - ix. Eksperiencia e Përgjithshme në Shërbime të Transportit (Formulari 10)
 - x. Eksperiencia e Përgjithshme në Projektim (Formulari 11)
 - xi. Eksperiencia e Veçantë (Formulari 12)
 - xii. Përmbledhje: Angazhimet Aktuale të Kontratës (Formulari 13)
 - xiii. Historiku Gjyqësor (Formulari 14)
 - xiv. Informacion Konfidencial (Formulari 15)
 - xv. Vetë Deklarimet e Ofertuesve të Huaj (Formulari 16)
- (b) Oferta teknike e përbërë nga dokumentet e mëposhtme (kolektivisht, "**Oferta Teknike**");
- (1) Përshkrimi teknik i projektit të përgatitur në përputhje me (a) Kriteret Minimale Teknike dhe Përshkrimi i Projektit (Shtojca 13 dhe Shtojca 14) dhe (b) Formulari i Propozimit Teknik *Shtojca 32 Formulari i Propozimit Teknik* (Formulari 17);
 - (2) Draft Kontrata e Koncensionit/Partneritetit Publik Privat me secilën faqe të sigluar nga Ofertuesi;



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

(c) Oferta financiare, e përbërë nga dokumentet e mëposhtme (kolektivisht, "**Oferta Financiare**"):

- (1) Propozimi financiar që tregon Periudhën e ofertuar të Konkensionit, Tarifën e ofruar të Konkensionit, Tarifat e ofruara të Terminalit duke përdorur Formularin e Ofertës Financiare *Shtojca 33 Formulari i Ofertës Financiare* (Formulari 18);
- (2) Propozimi i afateve që tregon numrin e ditëve ndërmjet nënshkrimit të Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat dhe datës së përfundimit të ndërtimit duke përdorur Formularin e Afatit të Ndërtimit (Shtojca 33);

4.2.2 Dokumentacioni Administrativ, Oferta Teknike dhe Oferta Financiare së bashku përbëjnë "**Ofertën**". Të dhënat e rreme përbëjnë një bazë ligjore për skualifikimin e Ofertuesit, dhe çdo gjetje se Ofertuesi ka dhënë informacione të rreme me dashje apo ka fshehur informacion material në ofertën e tij do të përbëjë arsye për ndërprerjen e Kontratës së Konkensionit/ Partneritetit Publik Privat. Ofertuesit duhet të përdorin vetëm dokumentet standarde të procesit të tenderimit, pa bërë asnjë ndryshim në kushtet e kontratës.

4.2.3 Përveç paragrafit 4.2.1 më sipër, ofertat e paraqitura nga një sipërmarrje e përbashkët ose konsorcium i dy ose më shumë shoqërive duhet të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

- (i) oferta duhet të përfshijë të gjithë informacionin përkatës siç kërkohet në paragrafin 4.2.1 a. (3) dhe 4.2.1 a. (4) për çdo shoqëri anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit;
- (ii) oferta do të nënshkruhet në mënyrë që të jetë ligjrisht e detyrueshme për të gjitha shoqëritë anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit;
- (iii) një nga shoqëritë anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit do të nominohet si udhëheqëse; ky autorizim duhet të dëshmohet në dorëzimin e ofertës nëpërmjet një prokure të posacme të nënshkruar nga nënshkruerit e autorizuar ligjrisht të të gjitha shoqërive anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit;
- (iv) shoqëria anëtare e sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit në krye do të autorizohet të pësojë detyrimet dhe të marrë udhëzime për dhe në emër të çdo dhe të gjitha shoqërive anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit, dhe ekzekutimi i tërë i kontratës do të bëhet ekskluzivisht me shoqëritë anëtare në krye;



- (v) të gjitha shoqëritë anëtare të sipërmarrjes së përbashkët do të jenë përgjegjëse bashkërisht dhe individualisht për ekzekutimin e kontratës në përputhje me kushtet e kontratës ;
- (vi) një kopje e marrëveshjes së lidhur nga shoqëritë anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit duhet të dorëzohet me ofertën.

4.2.4 Sipas paragrafit 2.3.2, një shoqëri mund të jetë anëtare vetëm në një sipërmarrje të përbashkët ose konsorcium; ofertat e dorëzuara nga sipërmarrjet e përbashkëta apo konsorciumet, duke përfshirë të njëjtën shoqëri anëtare do të refuzohen.

2.2.1 Ofertuesit nuk mund të propozojnë alternativa në ofertën e tyre.

2.3 Sigurimi i ofertës

4.3.1 Ofertuesi paraqet, si pjesë e ofertës së tij, një Sigurim Oferte në shumën e përcaktuar në *SEKSIONIN III paragrafi III.2, Sigurimi i Ofertës*, në monedhën e ofertës.

4.3.2 Sigurimi i Ofertës, sipas zgjedhjes së Ofertuesit, do të jetë në formën e një çeku të certifikuar, letër krediti ose një garancie bankare nga një bankë me reputacion të vendosur në vendin e Autoritetit Kontraktor ose jashtë vendit. Nëse banka që bën lëshimin e sigurisë së ofertës është themeluar jashtë Shqipërisë, ajo do të ketë një degë apo institucion financiar korrespondent të themeluar në vendin e Autoritetit Kontraktor për ta bërë atë të zbatueshme. Format i garancisë bankare duhet të jenë në përputhje me formularin e Sigurimit të Ofertës të përfshirë në dokumentet e tenderit (*Shtojca 3, Formulari i Sigurimit të Ofertës*); formate të tjera mund të lejohen, subjekt të miratimit paraprak të Autoritetit Kontraktor. Sigurimi i ofertës do të qëndrojë i vlefshëm për një periudhë prej njëzete e tetë (28) ditësh pas ditës së fundit të periudhës së vlefshmërisë së Tenderit original, dhe pas ditës së fundit të çdo zgjatje të periudhës së vlefshmërisë së tenderit në pajtim me paragrafin 4.6.2.

4.3.3 Ofertat e pa shoqëruar nga një Sigurim i pranueshëm Oferte do të trajtohen si jo të përgjegjshme dhe do të refuzohen. Sigurimi i ofertës së një sipërmarrjeje të përbashkët ose konsorciumi duhet të bëhen në emër të të gjitha shoqërive anëtare të sipërmarrjes së përbashkët ose konsorciumit që dorëzojnë ofertën.

4.3.4 Sigurimet e Ofertës së ofertuesve të pasuksesshëm do të kthehen sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se njëzet e tetë (28) ditë pas ditës së fundit të periudhës së vlefshmërisë së ofertave.



4.3.5 Sigurimi i Ofertës së Ofertuesit të Suksesshëm do të kthehet kur ofertuesi të ketë nënshkruar Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, dhe të ketë dhënë Sigurimin e kërkuar të Ekzekutimit.

4.3.6 Sigurimi i ofertës mund të konfiskohet:

- (a) nëse ofertuesi
 - (i) tërheq Ofertën e tij gjatë periudhës së vlefshmërisë së tenderit;
 - (ii) zhvlerëson ofertën e tij në pajtim me paragrafin 0.2.
- (b) në rast të një Ofertuesi të Suksesshëm, nëse Ofertuesi nuk arrin
 - (i) të nënshkruajë Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat në përputhje me paragrafin 7.2 ose
 - (ii) të japë një Siguri të Ekzekutimit, në përputhje me paragrafin 7.3 ose
 - (iii) të sigurojë Garanci Bankare Financiare në përputhje me paragrafin 7.4.

4.4 Deklarata e Konfliktit të Interesit

4.4.1 Në Dokumentacionin Administrativ, secili Ofertues (ose në qoftë se Ofertuesi është një Sipërmarrje e Përbashkët, secili anëtar i Sipërmarrjes së Përbashkët) do të sigurojë një deklaratë me shkrim të konfliktit të interesit, në thelb sipas formularit të bashkëngjitur këtu, në Shtojcën 6, në lidhje me ndonjë konflikt ekzistues, të mundshëm, ose që mund të jetë i mundur në të ardhmen që Ofertuesi (ose ndonjë anëtar i një sipërmarrje të përbashkët) mund të ketë me Procesin e Tenderit, Projektin, Autoritetin Kontraktor ose ndonjë agjenci, instrument, konsulent apo këshilltar të tij. Për qëllime të këtij paragrafi, "konflikti i interesit" do të përcaktohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar.

4.5 Monedhat e Ofertës

4.5.1 Monedha që do të përdoret për kuotimin e çmimeve dhe investimeve në këtë ofertë është ajo që tregohet në *SEKSIONIN IV paragrafi IV.7, Monedha*.

4.6 Periudha e vlefshmërisë së ofertës

4.6.1 Ofertat do të mbeten të vlefshme për periudhën e specifikuar në *SEKSIONIN IV paragrafi IV.5 Periudha e vlefshmërisë së ofertave*. Një ofertë e vlefshme për një periudhë më të shkurtër, do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor si ofertë jo e përgjegjshme.

4.6.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë pëlqimin e Ofertuesit ndaj një zgjatje të Periudhës së Vlefshmërisë së Tenderit. Kërkesa dhe përgjigjet e tij duhet të bëhen me shkrim, me faks ose me email. Nëse një Ofertues bie dakord të zgjasë periudhën e vlefshmërisë,



Sigurimi i Ofertës gjithashtu duhet të zgjatet në përputhje me rrethanat. Një Ofertues mund të refuzojë kërkesën, pa tërhequr Sigurimin e tij të Ofertës. Ofertuesi që jep kërkesën nuk do të kërkohej dhe as lejohet të modifikojë ofertën e tij.

4.7 Formati dhe nënshkrimi i Ofertës Origjinale

- 4.7.1 Oferta origjinale dhe të gjithë kopjet e ofertës duhet të shtypen ose të shkruhen me bojë që nuk fshihet. Oferta do të nënshkruhet nga ofertuesi ose personi (at) i autorizuar për të vepruar në emër të ofertuesit. Autorizimi i këtij të fundit do të evidentohet nëpërmjet një prokure të posaçme të marrë së bashku me Ofertën. Të gjitha faqet e Ofertës, përveç për literaturën e pandryshuar të shtypur, duhet të firmosen nga personi ose personat që nënshkruajnë Ofertën.
- 4.7.2 Çdo shtojcë, fshirje ose mbishkrim do të jetë i vlefshëm vetëm nëse siglohet nga personi ose personat që nënshkruajnë Ofertën.

3 Dorëzimi i Ofertave

3.1 Ngarkimi i Ofertave

- 3.1.1 Ofertuesi e përgatit dhe e dorëzon ofertën e tij në faqen e internetit të Agjencisë Shqiptare të Prokurimit Publik (APP). Informacione të hollësishme në lidhje me ngarkimin e ofertës mund të gjenden në manualin e përdoruesit, publikuar në faqen e internetit www.app.gov.al (vetëm në gjuhën shqipe).
- 3.1.2 Dosjet e ofertës të ngarkuara në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik janë të njëjta me ato të ofertës origjinale në format dhe të nënshkruara siç përcaktohet në paragrafin 4.7.
- 3.1.3 Në zbatim të VKM 130, datë 12 mars 2014, "Për kryerjen në mënyrë elektronike të procedurave konkurruese të dhënies së Koncesionit / PPP" dhe VKM 575, datë 10 korrik 2013 "Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve / partneriteve publike private", oferta do të dorëzohet në formë elektronike, në përputhje me udhëzimet e Agjencisë së Prokurimit Publik. Informacione të qarta të kësaj procedure mund të gjenden në faqen zyrtare të internetit www.app.gov.al.
- 3.1.4 Autoriteti Kontraktor nuk pranon asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve në lidhje me ndonjë pretendim apo ankesë mbi pasigurisë në mënyrën e dorëzimit të Ofertës përveç kur një aplikim nuk është siguruar siç duhet për



shkak të mungesës së infrastrukturës së duhur të përmirësuar nga Autoriteti Kontraktor.

3.1.5 Në çdo rast, ofertuesit paraqesin në mënyrë elektronike të gjithë dokumentacionin e detyrueshëm dhe të nevojshëm për prezantimin e Ofertës së tyre.

3.1.6 Ofertat e pranuar nga Autoriteti Kontraktor me anë të mjeteve të tjera përveç atyre të përshkruara në paragrafin 5.1.1 (psh dorazi, me email) do të refuzohen.

3.2 Afati për dorëzimin e ofertave

5.2.1 Ofertat duhet të pranohen nga Autoriteti Kontraktor jo më vonë se ora dhe data e deklaruar në *SEKSIONIN IV Afati për dorëzimin e Ofertave*.

3.2.1 Autoriteti Kontraktor mund të zgjasë këtë afat kohor për dorëzimin e ofertave duke ndryshuar dokumentet e tenderit, në pajtim me paragrafin 3.3, rast në të cilin të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktor dhe ofertuesve që më parë i nënshtroheshin afatit të mëparshëm, pas kësaj do t'i nënshtrohen afatit të zgjatur në kohë.

3.3 Ofertat e Vonuara

3.3.1 Ofertat e pranuar nga Autoriteti Kontraktor pas afatit të dorëzimit të ofertës, do të refuzohen.

3.4 Modifikimi dhe Tërheqja e Ofertave

3.4.1 Asnjë ofertë nuk mund të ndryshohet ose tërhiqet në intervalin ndërmjet afatit të fundit për dorëzim të ofertave dhe skadimit të periudhës së vlefshmërisë së ofertës së specifikuar në paragrafin 4.6.1. Tërheqja e ofertës gjatë këtij intervali mund të rezultojë në konfiskimin e Sigurimit të Ofertës së Ofertuesit, në pajtim me paragrafin 4.3.6.

4 Hapja dhe vlerësimi i ofertave

4.1 Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktor

4.1.1 Autoriteti Kontraktor do të hapë të gjitha ofertat në kohën, datën dhe në vendin e specifikuar në *SEKSIONI IV paragrafi IV.4 Afati kohor për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje*.

4.1.2 Autoriteti Kontraktor do të përgatisë procesverbalin e hapjes së ofertave duke përfshirë edhe emrat e ofertuesve, praninë ose mungesën e Sigurimit të Ofertës së kërkuar, Periudhën e Konkensionit, Tarifën e Konkensionit, zbritje në ta Tarifat e Terminalit, Periudhën e Ndërtimit, dhe të tjera të



dhëna ashtu sikurse Autoriteti Kontraktor, në diskrecionin e tij, i sheh të nevojshme.

4.2 Kontaktimi i Autoritetit Kontraktor

6.2.1 Në varësi të paragrafit 6.3, asnjë ofertues nuk do të kontaktojë Autoritetin Kontraktor për çështje që lidhen me ofertën e tij, nga koha e hapjes së ofertave deri në kohën e dhënies së kontratës fituese.

4.2.1 Përpjekjet nga një ofertues për të ndikuar në vlerësimin e Autoritetit Kontraktor ose në dhëniën e tenderit, duke përfshirë ofrimin ose dhënien e ryshfetit, dhuratave ose nxitjeve të tjera, mund të rezultojë në pavlefshmërinë e ofertës së tij dhe konfiskimin e sigurimit të ofertës së tij, në pajtim me paragrafin 4.3.6.

4.3 Sqarimi i Ofertave

4.3.1 Për të ndihmuar në ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave, Autoriteti Kontraktor mundet, në diskrecionin e tij, të kërkojë sqarim nga një ofertues për ofertën e tij. Sqarimi i tillë mund të kërkohet në çdo fazë deri në dhënien e kontratës. Kërkesat për sqarime dhe përgjigjet e tyre do të jenë në formë të shkruar, me faks ose me email, dhe asnjë ndryshim në thelbin e ofertës nuk duhet të kërkohet, ofrohet ose lejohet, përveç siç kërkohet për të konfirmuar korrigjimin e gabimeve kompjuterike të zbuluara nga Autoriteti Kontraktor në ekzaminimin e ofertave.



4.4 Shqyrtimi paraprak i ofertave

- 6.4.1 Autoriteti Kontraktor, do të shqyrtojë ofertat për të përcaktuar nëse ato janë të plota, nëse ndonjë gabim kompjuterik është bërë, nëse janë dhënë ose jo Sigurimet e kërkuara të Ofertës, nëse dokumentet janë nënshkruar si duhet, dhe nëse ofertat janë përgjithësisht në rregull.
- 6.4.2 Autoriteti Kontraktor mund të heqë dorë nga ndonjë informalitet i vogël, jo-konformitet ose parregullsi në një ofertë që nuk përbën devijim material, dhe që nuk do të paragjykojë ose ndikojë në renditjen relative të ndonjë ofertuesi, si rezultat i vlerësimit të detajuar në pajtim me paragrafët 6.5, 6.6 dhe 6.7.
- 6.4.3 Para vlerësimit të detajuar në pajtim me paragrafët 6.5, 6.6 dhe 6.7, Autoriteti Kontraktor do të përcaktojë nëse ofertat janë të cilësisë së pranueshme, janë të plota dhe në thelb të përgjegjshme për dokumentet e tenderit. Për qëllime të këtij përcaktimi, një ofertë e përgjegjshme në thelb është një ofertë që përputhet me të gjitha termat, kushtet dhe specifikimet teknike të DT pa devijime materiale, rezerva apo kundërshtime. Një devijim material, kundërshtim apo rezervim është një (i) që ndikon në ndonjë mënyrë substanciale qëllimin, cilësinë ose realizimin e kontratës; (ii) që kufizon në mënyrë substanciale, në kundërshtim me dokumentet e tenderit, të drejtat e Autoritetit Kontraktor ose obligimet e ofertuesit të suksesshëm sipas kontratës; ose (iii) ndreqja e të cilit do të ndikojë padrejtësisht pozicionin konkurrues të ofertuesve të tjerë të cilët kanë paraqitur oferta të përgjegjshme në thelb.
- 6.4.4 Në veçanti, devijimet nga, kundërshtimet ndaj apo rezervat rreth dispozitave kritike, si ato lidhur me Sigurimin e Ofertës, Legjislacionin e Zbatueshëm, Taksat dhe Tatimet, Garancinë Funktionale, Patentat dhe Dëmshpërblimet, Kufizimin e Përgjegjësisë, dhe kërkesat e lidhura, do të trajtohen si jo të përgjegjshme. Përcaktimi nga Autoriteti Kontraktor i ndjeshmërisë së një oferte është që të jetë i bazuar në përmbajtjen e vetë tenderit pa rekurs të provave jokarakteristike.
- 6.4.5 Nëse oferta nuk është e përgjegjshme në thelb, ajo do të refuzohet nga Autoriteti Kontraktor dhe si rrjedhojë nuk mund të bëhet e përgjegjshme nga ofertuesi duke korrigjuar devijimet e papërputhshme, kundërshtimet apo rezervimet.

4.5 Vlerësimi administrativ

- 4.5.1 Autoriteti Kontraktor do të kryejë vlerësimin e detajuar të Dokumentacionit Administrativ të ofertave të pa refuzuara më parë si jo të përgjegjshme në thelb për të përcaktuar nëse ato janë në përputhje me kriteret e përshtatshmërisë dhe kualifikimit.
- 4.5.2 Në rastin kur një ofertues është konsideruar " i kualifikuar me kusht" nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me paragrafin 2.2.5, Autoriteti Kon-



traktor mund t'i kërkojë ofertuesit që ky i fundit të modifikojë elemente të caktuara specifike brenda katërmbëdhjetë (14) ditëve nga kërkesa me shkrim e Autoritetit Kontraktor.

- 4.5.3 Ofertuesit që plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë dhe kualifikimit do të konsiderohen si "Ofertues të kualifikuar" dhe do të pranohen në fazën e ardhshme të procesit të vlerësimit të ofertave.
- 4.5.4 Autoriteti Kontraktor dërgon një njoftim skualifikimi (duke përdorur formularin e dhënë në Shtojcën 15) tek ofertuesit që nuk përmbushin kriteret e përshtatshmërisë dhe kualifikimit.

4.6 Vlerësimi Teknik

- 6.6.1 Autoriteti Kontraktor do të kryejë një vlerësim të detajuar teknik të ofertave të pa refuzuara më parë si të qenit në thelb jo-të përgjegjshme në mënyrë që të përcaktojë nëse aspektet teknike të ofertave të tilla janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Në kryerjen e vlerësimit të tillë teknik, Autoriteti Kontraktor do të shqyrtojë dhe krahasojë aspektet teknike të ofertave në bazë të informatave të furnizuara nga ofertuesit, duke marrë parasysh: (i) plotësinë e përgjithshme dhe pajtueshmërinë me Përshkrimin e Projektit; (ii) devijimet nga Kriteret Minimale Teknike të parashtruara në *Shtojcën 13 Specifikimet Teknike* sic identifikohen nga ofertuesi në ofertën e tij dhe ato devijime të pidentifikuara në këtë mënyrë; (iii), cilësinë, funksionin dhe funksionimin e çdo koncepti të kontrollit të procesit të përfshirë në Ofertë. Oferta që nuk plotëson standardet minimale të pranueshme të plotësisë, qëndrueshmërisë dhe detajimit do të refuzohet si jo e përgjegjshme.
- 6.6.2 Komisioni i vlerësimit do të vlerësojë Propozimet Teknike në bazë të ndjeshmërisë së tyre ndaj përshkrimit të projektit, duke aplikuar kriteret e vlerësimit, nënkriteret, dhe sistemin e pikëve të specifikuara në *Shtojcën 11 Kriteret e Vlerësimit*. Çdo Ofertuesi të përgjegjshëm do ti jepet një rezultat teknik. Një ofertë do të refuzohet në këtë fazë nëse ajo nuk i përgjigjet aspekteve të rëndësishme të dokumentave të tenderit, dhe veçanërisht Kriterëve Minimale Teknike ose nëse ajo nuk arrin rezultatin minimal teknik të treguar në *Shtojcën 11 Kriteret e Vlerësimit*.
- 6.6.3 Ku zgjidhjet alternative teknike lejohen dhe ofrohen nga ofertuesi, Autoriteti Kontraktor do të bëjë një vlerësim të ngjashëm të alternativave. Ku alternativat nuk lejohen, por janë ofruar, ato nuk do të merren parasysh.
- 6.6.4 Vlerësimi Teknik do të përmbillet me një Raport Vlerësimi, ku ofertuesve të pa refuzuar më parë do t'ju caktohet një rezultat teknik.



4.7 Vlerësimi Financiar

- 6.7.1 Vlerësimi i Autoritetit Kontraktor do të përfshijë gjithashtu vlerësimin e Propozimeve Financiare dhe Propozimin e Afateve të secilit Ofertues, caktimin e një rezultati financiar ofertuesve të pa refuzuar më parë dhe një rezultati kohor korrespondues nga aplikimi i faktorëve të vlerësimit siç jepet në *Shtojcën 11 Kriteret e Vlerësimit*. Në rast të mospërputhjes ndërmjet fjalëve dhe figurave, të parat do të mbizotërojnë.
- 6.7.2 Propozimet do të renditen sipas pikëve të kombinuara të tyre teknike, financiare dhe kohore. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik, financiar dhe kohor do të ftohet për negociim.

6.8 E drejta e Autoritetit Kontraktor për të pranuar ndonjë ofertë dhe për të refuzuar ndonjë ose të gjitha ofertat

- 6.8.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për të pranuar ose refuzuar ndonjë ofertë, për të anuluar procesin e tenderit dhe për të refuzuar të gjitha ofertat në çdo kohë para dhënies së kontratës, në këtë mënyrë, pa asnjë detyrim për ofertuesit apo ndonjë obligim për të informuar ofertuesin ose ofertuesit për arsyet e veprimit të tij.

5 Dhënia e Kontratës

7.1 Komunikimi i klasifikimit përfundimtar

- 5.1.1 Pas përfundimit të vlerësimit të ofertës, Autoriteti Kontraktor duhet të njoftojë menjëherë të gjithë ofertuesit që kanë dorëzuar propozime mbi renditjen e ofertuesve nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.
- 5.1.2 Pas njoftimit të klasifikimit përfundimtar, secili ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat" dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 10 korrik 2013, "*Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve / partneritetit publik privat*", duke përdorur Formularin e Ankimit të përcaktuar në Shtojcën 21.

5.2 Përcaktimi i ofertuesit të suksesshëm

- 5.2.1 Pas skadimit të periudhës së ankimit të përmendur në Seksionin 7.1.2, Autoriteti Kontraktor do të nxjerrë Njoftimin e Ofertuesit të Suksesshëm në formularin e bashkëngjitur këtu nën *Shtojcën 16 Formulari i Njoftimit të Pranimit të Ofertës*, për Ofertuesin oferta e të cilit ka marrë rezultatin më të lartë përfundimtar ("**Ofertuesi i Suksesshëm**").



- 5.2.2 Ofertuesi i suksesshëm do t'i paraqesë Autoritetit Kontraktor ofertën origjinale në adresën e specifikuar në *SEKSIONIN I paragrafin I.1* brenda shtatë ditëve nga data e Njoftimit të Ofertuesit të Suksesshëm.
- 5.2.3 Ofertuesi i Suksesshëm do të ftohet për seksionin e negocimit dhe finalizimit të përcaktuar në paragrafin 7.5, dhe do të kërkohet të ofrojë sigurimin e ekzekutimit dhe garancinë financiare bankare (siç përcaktohet në Draft Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat) dhe të nënshkruajë Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat brenda 30 ditëve nga data e Njoftimit të Ofertuesit të Suksesshëm.

5.3 Sigurimi i Ekzekutimit të Kontratës

- 5.3.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e Njoftimit të Ofertuesit të Suksesshëm, Ofertuesi i Suksesshëm do të japë Sigurimin e Ekzekutimit të Kontratës në pajtim me Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat dhe në formën e parashikuar në Shtojcën 19 ose në një formë të pranueshme për Autoritetin Kontraktor.

5.4 Garancia Financiare Bankare

- 5.4.1 Brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e Njoftimit të Ofertuesit të Suksesshëm, Ofertuesi i Suksesshëm do të japë një Garanci Financiare Bankare si dëshmi që Banka ose një institut udhëheqës ndërkombëtar financiar ka hyrë në një marrëveshje me ofertuesin e suksesshëm për të financuar Projektin. Garancia Financiare Bankare duhet të jetë në përputhje me Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat dhe në formën e parashikuar në Skedulën 20 të Draft Kontratës së Konkensionit / Partneritetit Publik Privat, ose në një formë tjetër të pranueshme për Autoritetin Kontraktor.

5.4.2 Negocimi dhe finalizimi i kontratës

- 5.4.3 Në rrjedhën e seksioneve të finalizimit, Autoriteti Kontraktor dhe Ofertuesi i Suksesshëm, me kujdesin e duhur për trajtimin e drejtë të Ofertuesit, do të diskutojnë, negociojnë dhe do të bien dakord në mirëbesim për çështje të caktuara në pritje të përcaktuara shprehimisht në Draft Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Privat Publik, të cilat kërkojnë diskutime të mëtejshme dhe negociata me Ofertuesit e Suksesshëm, dhe kushtet përfundimtare si dhe kushtet e Kontratës së Konkensionit do të modifikohen në përputhje me rrethanat; sidoqoftë, me kusht që, përveç atyre çështjeve specifike pezull, Autoriteti Kontraktor do të bëjë vetëm ndryshime të vogla për draftimin për qëllime të qartësisë dhe kastimizimit të Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, dhe Ofertuesi i Suksesshëm do të kërkohet të nënshkruajë Kontratën e



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

Koncensionit/Partneritetit Publik Privat në formën e kopjeve të sigluara, të dorëzuara si pjesë e ofertës së tij teknike, të ndryshuar, si gjatë procesit të finalizimit.

7.6 Lirimi i Sigurisë së Ofertës

- 7.6.1 Nëse brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e Njoftimit të Ofertuesit të Suksesshëm, bëhet e qartë për Autoritetin Kontraktor që Ofertuesi i Suksesshëm nuk do të përputhet me kërkesat e paragrafit 7.3.1 dhe/ose paragrafit 7.4 dhe / ose të nënshkruajë kontratën e Koncensionit/ Partneritetit Publik Privat, Autoriteti Kontraktor do të ketë të drejtë të konfiskojë Sigurimin e Ofertës së Ofertuesit të Suksesshëm dhe të ftojë për negociata Ofertuesit e tjerë sipas klasifikimit të tyre derisa ai të marrë një sigurim të ekzekutimit të kontratës dhe një garanci financiare bankare dhe nënshkruan kontratën e Koncensionit/ Partneritetit Publik Privat ose ndryshe refuzon të gjitha ofertat e mbetura.
- 7.6.2 Pas ofrimit nga Ofertuesi i Suksesshëm të Sigurimit të Ekzekutimit të Kontratës dhe Garancisë Bankare Financiare (siç përcaktohet në draft kontratën e Koncensionit/Partneritetit Publik Privat) dhe pas nënshkrimit të kontratës së Koncensionit / Partneritetit Publik Privat nga Ofertuesi i Suksesshëm, Autoriteti Kontraktor do të njoftojë menjëherë emrin e Ofertuesit të Suksesshëm për çdo ofertues të pasuksesshëm dhe do të lirojë sigurimin e tenderit të ofertuesve të pasuksesshëm.

6 Të ndryshme

6.1 Konfidencialiteti

- 6.1.1 Informacioni në lidhje me vlerësimin e ofertave dhe rekomandimeve në lidhje me dhëniën e kontratës nuk do të zbulohet për Ofertuesit të cilët kanë dorëzuar ofertat apo për persona të tjerë të interesuar jo zyrtarisht me procesin, deri në publikimin e dhënies së kontratës. Përdorimi i papërshtatshëm nga ndonjë Ofertues i informacionit konfidencial në lidhje me procesin mund të rezultojë në refuzimin e ofertës së tij.



Shtojcat

| | | |
|----------------------------|--|-------|
| Shtojca 1 | Formulari i Dorëzimit të Ofertës | 31 |
| Shtojca 2 | Ftesa për Ofertë | 37 |
| Shtojca 3 | Formulari i Sigurimit të Ofertës Error! Bookmark not defined. | |
| Shtojca 4 | Informacioni Konfidencial (Formulari 15) | 409 |
| Shtojca 5 | Deklarata e plotësimit të kërkesave të dokumenteve standarde të Konkensionit / partneritetit publik privat (Formulari 4) | 50 |
| Shtojca 6 | Deklarata mbi Konfliktin e Interesit (Formulari 5) | 51 |
| Shtojca 7 | Eksperiencia e Vecantë (Formulari 12) | 53 |
| Shtojca 8 | Deklarata e disponueshmërisë së makinerisë | 47 |
| Shtojca 9 | Dëshmi Kualifikimi / Formular i Pjesëmarrjes Error! Bookmark not defined. | |
| Shtojca 10 | Deklarata mbi statusin ligjor (Formulari 3) | 55 |
| Shtojca 11 | Kriteret e Vlerësimit | 56 |
| Shtojca 12 | Vetë-deklarimet për Ofertuesit e Huaj (Formulari 16) | 73 |
| Shtojca 13 | Specifikimet Teknike | 74 |
| Shtojca 14 | Termet e Referencës | 93 |
| Shtojca 15 | Formulari i Njoftimit të Skualifikimit | 94 |
| Shtojca 16 | Formulari i Njoftimit të Pranimi të Ofertës | 85 |
| Shtojca 17 | Kushtet e Përgjithshme të Kontratës | 879 |
| Shtojca 18 | Kushtet e Veçanta të Kontratës | 100 |
| Shtojca 19 | Formulari i Sigurimit të Ekzekutimit | 101 |
| Shtojca 20 | Formulari i publikimit të njoftimit të dhënies së kontratës | 102 |
| Shtojca 21 | Formuari i Ankimit për Autoritetin Kontraktor | 104 |
| Shtojca 22 | Prokurë e Posaçme (Formulari 1) | 95 |
| Shtojca 23 | Informacione të Përgjithshme (Formulari 2) | 98 |
| Shtojca 24 | Eksperiencë e Përgjithshme në Ndërtim (Formulari 8) | 99 |
| Shtojca 25 | Eksperiencë e Përgjithshme Ndërtime Rrugore (Formulari 9) | 10113 |



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

| | | |
|----------------------------|---|-------|
| Shtojca 26 | Eksperiencë e Përgjithshme Shërbime Transporti (Formulari 10) | 10214 |
| Shtojca 27 | Eksperiencë e Përgjithshme në Projektim (Formulari 11) | 103 |
| Shtojca 28 | Përmbledhje: Angazhime të Kontratës Aktuale (Formulari 13) | 104 |
| Shtojca 29 | Aftësia Financiare (Formulari 7) | 105 |
| Shtojca 30 | Historiku Gjyqësor (Formulari 14) | 108 |
| Shtojca 31 | Dokumente të Përgjithshme Kualifikimi (Formulari 6) | 122 |
| Shtojca 32 | Formulari i Propozimit Teknik (Formulari 17) | 109 |
| Shtojca 33 | Formulari i Ofertës Financiare (Formulari 18) | 113 |
| Shtojca 34 | Formulari i Kohës së Ndërtimit (Formulari 19) | 115 |
| Shtojca 35 | Marrëveshja e Konfidencialitetit | 116 |





Shtojca 1 Formulari i Dorëzimit të Ofertës

[Shtojcë për t'u dorëzuar nga operatori ekonomik]

[Letër me kokë e Ofertuesit, ose partnerit kryesor të një sipërmarrje të përbashkët, duke përfshirë adresën e plotë postare, nr. e telefonit, nr. faks, adresë e-mail, nr. teleks dhe adresën kabllore]

Datë:

Drejtuar: [emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor]

Procedura e Konkensionit / partneritetit publik privat: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Datë] [Numër]

Zotërinj,

Të autorizuar për të përfaqësuar dhe për të vepruar në emër të (më tej "Ofertuesi"), dhe pasi kemi shqyrtuar dhe kemi kuptuar plotësisht të gjitha dokumentet e tenderit të siguruara duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne të nënshkruarit deklarojmë që kemi shqyrtuar me kujdes dhe nuk kemi rezerva për dokumentet e tenderit, siç përcaktohet në Udhëzimet për Ofertuesit, paragrafi 3.1.1, duke përfshirë shtesat e lëshuara në përputhje me Udhëzimet për Ofertuesit, paragrafi 3.3;

Ato njihen dhe përmbajtjet e tyre pranohen. Ne kemi ekzaminuar kushtet aktuale të terrenit, jemi të kënaqur me llojin dhe lokacionin e punimeve dhe shërbimeve të përmendura më lartë dhe kushtet e përgjithshme dhe vendore që do të hasen gjatë zbatimit të tyre.

Ne ofrojmë të kryejmë të gjitha shërbimet dhe detyrimet e Koncesionarit të parashikuara sipas Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, në përputhje të plotë me Dokumentet e Tenderit.

Ne autorizojmë Autoritetin Kontraktor të verifikojë informacionin / dokumentet bashkëngjitur Ofertës sonë.

Nëse Oferta jonë pranohet, ne marrim përsipër të ofrojmë Sigurimin e Ekzekutimit (siç përcaktohet në Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat) brenda kohës së specifikuar në Njoftimin e Ofertuesit të Suksesshëm.

Ne jemi dakord t'i përmbahemi kësaj Oferte, e cila përbëhet nga Oferta jonë Teknike dhe Financiare (secila siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit), për një periudhë



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

prej njëqind e pesëdhjetë (150) ditësh nga afati i fundit për Dorëzimin e Ofertave, siç përcaktohet në Dokumentet e Tenderit, dhe ajo do të mbetet detyruese mbi ne dhe mund të pranohet nga ju në çdo kohë para skadimit të kësaj periudhe.

Deri në një Kontratë formale Koncesioni/Partneriteti Publik Privat ndërmjet nesh, Oferta jonë, së bashku me pranimin tuaj të saj me shkrim do të përbëjnë një kontratë detyruese mes nesh.

Nëse ne zgjidhemi si Ofertuesi i Suksesshëm, ne jemi dakord të ofrojmë Sigurimin e Ekzekutimit dhe të ekzekutojmë Kontratën e Koncesionit/ Partneritetit Publik Privat pa asnjë rezervë ose kufizim, në përputhje me Projektin.

Në atë masë që ndonjë dispozitë në Ofertën tonë bie në konflikt me termat dhe kushtet e Dokumenteve të Tenderit, një dispozitë e tillë tërhiqet me anë të këtij dokumenti.

Ne e kuptojmë se ju nuk jeni të detyruar të pranoni çfarëdolloj oferte që ju paraqitet.

Ne pranojmë dhe pajtohemi që Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë gabim ose mosveprim nga ana jonë në përgatitjen e kësaj Oferte, dhe ne do ta dëmshpërblejmë Autoritetin Kontraktor plotësisht në lidhje me to².

Ne jemi përgjegjës për të gjitha kostot, shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara në përgatitjen dhe dorëzimin e Ofertës sonë. Autoriteti Kontraktor nuk do të na kompensojë për ndonjë kosto të tillë, shpenzim ose humbje pavarësisht nga rezultati i Procesit të Tenderit.

2. Bashkangjitur me këtë dokument janë kopjet e dokumenteve origjinale që përcaktojnë:

- (a) statusin ligjor të ofertuesit;
- (b) vendin e tij kryesor të aktivitetit; dhe
- (c) vendin e tij të themelimit (për Ofertuesit të cilët janë korporata); ose vendin e tij të regjistrimit (për Ofertuesit të cilët janë ortakëri apo firma në pronësi individuale).

² Shënim për Ofertuesit: kjo nënkupton se Ofertuesit nuk do të kenë të drejtë të padisin Autoritetin Kontraktor në rast se kanë bërë gabime në Ofertat e tyre bazuar në gabimet e përfshira në Dokumentet e Tenderit.



Për ofertat nga sipërmarrje të përbashkëta, i gjithë informacioni i kërkuar në dokumentet e para-kualifikimit do të sigurohet për sipërmarrjen e përbashkët, në qoftë se ajo tashmë ekziston, dhe për secilën palë në sipërmarrjen e përbashkët veç e veç. Partneri kryesor duhet të identifikohet qartë. Secili partner në një sipërmarrje të përbashkët nënshkruan dokumentin.

Për ofertat që përfshijnë nënkontraktorë të specializuar për kualifikim, informacioni i kërkuar në dokumentet e para-kualifikimit duhet të sigurohet për secilin nënkontraktor të specializuar.

3. Ju dhe përfaqësuesit tuaj të autorizuar, autorizohen të bëjnë pyetje apo hetimet për të verifikuar deklaratat, dokumentet dhe informatat e paraqitura në lidhje me këtë aplikim, dhe për të kërkuar sqarim nga bankierët dhe klientët tanë në lidhje me të gjitha aspektet financiare dhe teknike. Ky Aplikim për Ofertë do të shërbejë gjithashtu si autorizim për përfaqësues individualë ose të autorizuar të ndonjë institucioni të përmendur në informacionin mbështetës, për të siguruar informacionin e nevojshëm të kërkuar nga ju, për të verifikuar deklaratat dhe informatat e dhëna në këtë aplikim, të tilla si burimet, eksperiencia dhe kompetenca të Ofertuesit.

4. Ju dhe përfaqësuesit tuaj të autorizuar mund të kontaktojnë personat e mëposhtëm për informacion të mëtejshëm:

| Të dhëna të përgjithshme dhe menaxheriale | |
|---|-----------|
| Kontakt 1 | Telefon 1 |
| Kontakt 2 | Telefon 2 |

| Të dhëna teknike | |
|------------------|-----------|
| Kontakt 1 | Telefon 1 |
| Kontakt 2 | Telefon 2 |



Të dhëna financiare

Kontakt 1

Telefon 1

Kontakt 2

Telefon 2

Ofertat nga sipërmarrjet e përbashkëta duhet të ofrojnë në një fletë të veçantë të dhënat e kërkuara për secilën palë të aplikimit.

Ofertuesit që përdorin një ose më shumë nënkontraktorë të specializuar për kualifikim duhet të sigurojnë në një fletë të veçantë të dhënat e kërkuara për secilin nënkontraktor të tillë.

5. Ky aplikim është bërë në mirëkuptim të plotë që:

- (a) ofertat nga ofertuesit e kualifikuar do të jenë subjekt i verifikimit të të gjithë informacionit të paraqitur për kualifikim në kohën e tenderimit;
- (b) ju keni të drejtë:
 - të ndryshojë qëllimin dhe vlerën e kontratës së tenderuar në këtë projekt; në një rast të tillë, ofertat do të ftohen vetëm nga Ofertuesit e kualifikuar që përmbushin kërkesat e rishikuara; dhe
 - të refuzoni apo të pranoni ndonjë kërkesë, të anuloni procesin e kualifikimit, dhe të refuzoni të gjitha ofertat; dhe
- (c) ju nuk do të jeni përgjegjës për ndonjë veprim të tillë dhe nuk do të keni as detyrimin të informoni Ofertuesin duke shpjeguar arsyet e veprimeve të tilla.

Ofertuesit të cilët nuk janë sipërmarrje të përbashkëta, do të fshijnë paragrafët 6 dhe 7.

6. Bashkangjitur me këtë aplikim, ne japim detajet e pjesëmarrjes së secilës palë, duke përfshirë edhe kontributin e kapitalit dhe marrëveshjet e fitimit / humbjes, në sipërmarrjen e përbashkët ose asociimin. Ne gjithashtu specifikojmë angazhimin fi-



nanciar në aspektin e përqindjes së vlerës së kontratës, dhe përgjegjësitë për ekzekutimin e kontratës.

7. Ne konfirmojmë se në rast se ne ofertojmë, ajo ofertë, si dhe çdo kontratë që rezulton:

(a) do të jenë të nënshkruara në mënyrën e tillë që të lidhin ligjërisht të gjithë partnerët, bashkërisht dhe individualisht; dhe

(b) do të paraqitet së bashku me një marrëveshje të përkueshme sipërmarrje të përbashkët, në thelb në përputhje me të dhënat e sipërmarrjes së përbashkët të përshkruara në dorëzim sipas paragrafit 6 më sipër dhe duke siguruar përgjegjësi të përbashkët dhe solidare të të gjithë partnerëve në rast se kontrata n'a jepet ne.

Ofertuesit që nuk përdorin nënkontraktorë të specializuar për kualifikim duhet të fshijnë paragrafin 8.

8. Bashkangjitur me këtë aplikim, japim detaje të nënkontraktorit (ëve) të specializuar dhe përvojën e tyre.

9. I nënshkruari garanton që në datën e këtij dokumenti Ofertuesi, duke përfshirë anëtarët e tij të sipërmarrjes së përbashkët [nëse zbatohet]

(a) nuk është në procedura falimentimi apo likuidimi,

(b) nuk është dënuar për mashtrim, korrupsion, bashkëpunim apo pastrim të parave, dhe

(c) nuk është në dijeni të ndonjë konflikti interesi rezultues nga kontratat e mëparshme ose ekzistuese ose marrëdhënie të cilat mund të ndikojnë materialisht aftësinë e tij për të përmbushur detyrimet sipas kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

10. I nënshkruari deklaron se deklaratat e bëra dhe informacioni i dhënë në aplikimin e plotësuar në mënyrë të rregullt janë të plota, të vërteta dhe të sakta në çdo detaj.

| | |
|------------|------------|
| Nënshkruar | Nënshkruar |
|------------|------------|



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

| | |
|---|---------------------------------------|
| Emri | Emri |
| Për dhe në emër të (emri i Ofertuesit ose partneri kryesor i një sipërmarrje të përbashkët) | Për dhe në emër të (emri i partnerit) |
| Nënshkruar | Nënshkruar |
| Emri | Emri |
| Për dhe në emër të (emri i partnerit) | Për dhe në emër të (emri i partnerit) |
| Nënshkruar | Nënshkruar |
| Emri | Emri |
| Për dhe në emër të (emri i partnerit) | Për dhe në emër të (emri i partnerit) |



Shtojca 2 Ftesa për Ofertë

Bashkia e Tiranës fton investitorët e interesuar vendas dhe / ose të huaj për të marrë pjesë në procedurat konkurruese përzgjedhëse për koncesionin/ partneritetin publik privat.

Vendndodhja dhe mënyrat e tërheqjes së dokumenteve të tenderit do të bëhen në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 18.04.2012 "Për kryerjen e procedurave të tenderimit elektronik të Konkensionit / Partneritetit Publik Privat".

Ofertuesit e interesuar mund të njihen me dokumentet standarde të procedurës konkurruese në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik:

www.app.gov.al.

Kohëzgjatja e Konkensionit / partneritetit publik privat është: në bazë të periudhës së ofruar nga Ofertuesi fitues (ndërmjet 15 dhe 35 vjet) ;.

Për më shumë informacion në lidhje me procedurën, ju lutem na kontaktoni duke përdorur informacionin e kontaktit dhënë në Seksionin 1.2:

Ofertat duhet të ngarkohen në adresën zyrtare të APP-së: www.app.gov.al, jo më vonë se data dhe koha e shënuar në Seksionin IV

Aplikimet e ngarkuara pas këtij afati nuk do të pranohen.

MIRATUAR

Kryetari i Autoritetit Kontraktor



Shtojca 3 Formular i Sigurimit të Ofertës

[Shtojcë për t'u dorëzuar nga operatori ekonomik]

[Letër me Kokë e Bankës]

LETËR GARANCIE

Datë:

Emri i Kontratës:

Drejtuar: (Emri dhe Adresa e Autoritetit Kontraktor)

DUKE PATUR PARASYSH SE (emri i ofertuesit duke përfshirë emrat e të gjithë anëtarëve të sipërmarrjes së përbashkët) (referuar më tej "Ofertuesi") ka dorëzuar ofertën e tij më datë (data e ofertës) për kryerjen e Kontratës së referuar më lart (referuar më tej "Oferta")

ME ANË TË KËTIJ DOKUMENTI bëjmë me dije se NE (emri i bankës) i (adresa e bankës) (referuar më tej "Banka"), jemi në detyrim ndaj (emri i Autoritetit Kontraktor) (referuar më tej "Autoriteti Kontraktor") në shumën prej:

.....

Pagesë e cila që të kryhet mirë dhe në të vërtetë për Autoritetin Kontraktor, Banka del garant vetë, vendos pasuesit e saj dhe të caktuarit e saj me anë të këtij dokumenti.

Nënshkruar në emër të Bankës në fjalë sot, mëdita e201_

KUSHTET e këtij detyrimi janë:

1. Nëse Ofertuesi e tërheq ofertën e tij gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertave të specifikuar nga Ofertuesi në formularin e tenderit, ose
2. Nëse Ofertuesi zhvlerëson ofertën e tij në pajtim me angazhimin në praktikat korruptuese, mashtruese, marrëveshje të fshehta shtrënguese ose konkurruese për Kontratën, ose
3. Nëse Ofertuesi, pas njoftimit të pranimit të Ofertës së tij nga Autoriteti Kontraktor gjatë periudhës së vlefshmërisë së ofertave:

(a) nuk nënshkruan ose refuzon të nënshkruajë Kontratën kur kërkohet, ose



(b) nuk arrin ose refuzon të lëshojë Sigurimin e Ekzekutimit, në përputhje me dokumentet e tenderit.

Marrim përsipër të paguajmë Autoritetin Kontraktor deri në shumën e mësipërme pas pranimit të kërkesës së tij të parë me shkrim, pa qenë e nevojshme që Autoriteti Kontraktor të mbështesë kërkesën e tij, me kusht që në kërkesën e tij Autoriteti Kontraktor të vë re se shuma e pretenduar nga ai është për shkak të ndodhjes së një ose më shumë prej KUSHTEVE të mësipërme, duke specifikuar kushtin ose kushtet e ndodhura.

NE do ti paguajmë Autoritetit Kontraktor shumën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e një kërkesë zyrtare me shkrim nga Autoriteti Kontraktor dhe pavarësisht nga çdo kundërshtim nga Ofertuesi ose ndonjë palë tjetër një shumë të tillë apo shumat sikurse Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë pa tejkalar shumën agregate të përmendur më lart, me transferim bankar në llogarinë e Autoritetit Kontraktor në çdo bankë në Republikën e Shqipërisë ose në ndonjë mënyrë tjetër të pranueshme për Autoritetin Kontraktor;

Të gjitha pagesat e kryera në bazë të kërkesës së Autoritetit Kontraktor do të jenë të lira dhe të pastra nga, dhe pa ndonjë zbritje aktuale apo të ardhshme për pagesën e, tatimeve, taksave, tarifave, pagesave, zbritjeve apo mbajtjeve në burim të ndonjë lloji natyre dhe të tjera imponime;

Ndërmarrjet e përfshira në këtë garanci përbëjnë detyrimet e drejtpërdrejta dhe themelore të Bankës dhe janë të pakushtëzuara dhe të parevokueshme. Ne nuk do të lirohemi nga ndonjë ose të gjitha këto detyrime, për ndonjë arsye apo shkaqe të çfarëdo natyre apo ndonjë burimi apo mosveprimi, akte apo procedura nga Autoriteti Kontraktor ose nga një palë e tretë e cila do të na falë apo shkarkojë prej obligimeve dhe detyrimeve të deklaruara në këtë garanci;

Kjo garanci do të mbetet në fuqi të plotë deri në dhe duke përfshirë (*datën njëzet e tetë (28) ditë pas periudhës së vlefshmërisë së ofertave*), dhe pyetjet në lidhje me to duhet ti adresohen Bankës jo më vonë se data e mësipërme.

Kjo garanci do të qeveriset nga dhe interpretohet në përputhje me ligjet, rregulloret, vendimet, rregullat dhe udhëzimet e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mosmarrëveshje në lidhje me këtë garanci do të zgjidhet ekskluzivisht nga autoritetet kompetente në Republikën e Shqipërisë dhe në përputhje me rregulloret, vendimet, rregullat dhe udhëzimet shqiptare.

Për dhe në emër të Bankës

.....
(Nënshkrimi i Autorizuar)

.....
(Nënshkrimi i Autorizuar)

.....
(titulli)

.....
(titulli)



Shtojca 4 Informacioni Konfidencial (Formulari 15)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

(Shënoni më poshtë informacionin që dëshironi të mbahet konfidencial.)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet të mbetet konfidencial | Numri i faqeve dhe pikat në Dokumentet Standarde të Koncensionit / PPP që dëshironi të mbahen konfidenciale | Arsyet pse ky informacion duhet të mbetet konfidencial | Afati kohor që ky informacion të mbetet konfidencial |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |



Shtojca 5 Deklarata e plotësimit të kërkesave të dokumenteve standarde të Konkensionit / partneritetit publik privat (Formulari 4)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet më _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ në lidhje me _____

Unë, i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të Operatorit Ekonomik _____ deklaroj në këtë dokument se:

Përbushim të gjitha kriteret e kualifikimit të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit të Konkensionit / Partneritetit Publik Privat dhe i pranojmë ato pa rezerva dhe pa ndonjë kundërshtim. Ne deklarojmë dhe pranojmë se jemi dakord me të gjitha specifikimet teknike dhe përbushim të dhënat e përcaktuara në këto dokumente të Konkensionit / Partneritetit Publik Privat. Ne përbushim të gjitha kriteret ligjore, financiare-ekonomike, si dhe eksperiencën teknike të përcaktuar në procedurën konkurruese të dokumenteve standarde, dhe verifikojmë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në këtë deklaratë.

Ne nuk marrim pjesë si Ofertues në më shumë se një Aplikim për këtë procedurë.

Ne autorizojme Autoritetin Kontraktor të verifikojë informacionin / dokumentet bashkëngjitur aplikimit.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula



Shtojca 6 Deklaratë mbi konfliktin e interesave (Formulari 5)

(Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

E operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e Konkensionit/partneritetit publik privat të zhvilluar më datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësive të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohet në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, zvkryeministri, ministrat, ose zvministrat, Deputetet,
- Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ose Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive,
- Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; mediae),
- Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me Drejtorët e Përgjithshëm.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e ligjit nr.9367, datë 7.4.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1,2 te ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë bashkëshorti/ja, fëmijë madhorë apo prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit/es (me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, duhet të shtohet gjithadhtu edhe bashkëjetuesi.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:




Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të ligjit nr. 125/2013“Për Koncensionet dhe partneritetin publik privat”.

Në përputhje me legjislacionin e përmendur më lart, deklaroj dhe pranoj se asnjë zyrtar i përcaktuar në Kreun III, Seksioni II të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula





Shtojca 7 Eksperiencia e Veçantë (Formulari 12)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

Për t'u kualifikuar, Ofertuesi duhet të kalojë kriteret e specifikuar, të përcaktuara në *Shtojcën 9*.

Në një faqe të veçantë, duke përdorur formatin e Formularit 12A, Ofertuesi duhet të listojë të gjitha kontratat e një vlere të barabartë me vlerën e specifikuar në *Shtojcën 9 Dëshmi të Kualifikimit/Formulari i Pjesëmarrjes*, të një lloji dhe kompleksiteti të ngjashëm me kontratën për të cilën Ofertuesi dëshiron të kualifikohet dhe të ndërmarrë gjatë pesë viteve të fundit. Vlera duhet të bazohet në monedhat e kontratave, e konvertuar në euro, në datën e përfundimit, ose për kontratat aktuale në datën e dorëzimit. Informacioni duhet të përmbledhet duke përdorur Formularin 12A, për çdo kontratë të përfunduar ose në ekzekutim nga Ofertuesi ose nga secili partner i një sipërmarrjeje të përbashkët.

Shumat dhe periudhat duhet të jenë në përputhje me ato të specifikuar në kriteret e kualifikimit të përcaktuara në **Error! Reference source not found.**

Kur Ofertuesi propozon të përdorë nënkontraktorë të specializuar për ato pjesë kritike të punëve / shërbimeve siç përcaktohet në *Shtojcën 9*, për secilin nënkontraktor specialist do të jepet gjithashtu informacioni në Formularin 12A.

**Detaje të Kontratave të llojit dhe kompleksitetit të ngjashëm (Formulari 12A)**

Emri i Ofertuesit / partnerit të një sipërmarrje të përbashkët / nënkontraktorit të specializuar

Përdorni një fletë të veçantë për secilën kontratë.

| | | |
|----|---|--|
| 1. | Numri i kontratës | |
| | Emri i kontratës | |
| | Vendi | |
| 2. | Emri i Autoritetit Kontraktor | |
| 3. | Adresa e Autoritetit Kontraktor | |
| | | |
| 4. | Lloji i punimeve / shërbimeve dhe karakteristikat e veçanta | |



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

| | |
|-----|--|
| 5. | Roli në kontratë (zgjidhni një) <input type="checkbox"/> Kontraktor i Vetëm <input type="checkbox"/> Nënkontraktor <input type="checkbox"/> Kontraktor Menaxhimi <input type="checkbox"/> Partner në një Sipërmarrje të Përbashkët |
| 6. | Vlera totale e kontratës / nënkontratës / pjesës së partnerit (në monedha të specifikuar në përfundim, ose në datën e dhënies së kontratës për kontratat aktuale) |
| | Monedha Monedha Monedha |
| 7. | Vlera ekuivalente në Euro |
| 8. | Data e Dhënies së Kontratës |
| 9. | Data e Përfundimit |
| 10. | Kohëzgjatja e Kontratës/Nënkontratës (vite dhe muaj) vite muaj |
| 11. | Kriteret e Specifikuara |
| 12. | Për kontraktorët e vetëm / kryesorë, tregoni shumën e përafërt në Euro dhe llojin e punës / shërbimit (më shumë se 20 për qind të vlerës së kontratës) ndërmarrë në nënkontratë, nëse ka. |

Ofertuesi duhet të bashkëngjisë:

- një certifikatë të përfundimit të kënaqshëm të nënshkruar nga Klienti;

Në rast të punimeve në progress:

- një kopje të kontratës së nënshkruar dhe gjendjes së përfundimit të punimeve me kopje të faturave përkatëse.



Shtojca 8 Deklarata e disponueshmërisë së makinerive

Kjo Shtojcë nuk zbatohet në këtë procedurë ofertimi.





Shtojca 9 Dëshmi të Kualifikimit /Formulari i Pjesëmarrjes

[Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik]

1. Kriteret e Përgjithshme të Pranueshmërisë /Kualifikimit

Ofertuesi dorëzon:

1. Një dokument që provon se (subjekti juaj):
 - a. nuk është në proces falimentimi,
 - b. nuk është i dënuar për ndonjë vepër penale, sipas nenit 45/1 të LPP-së,
 - c. nuk është dënuar me vendim të formës së prerë përse i përket aktivitetit të tij profesional, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
2. Një dokument i cili vërteton se (shoqëria juaj):
 - a. ka paguar detyrimet fiskale,
 - b. i ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, ose, në rastin e aplikantëve të huaj, një dokument ekuivalent të vendit të origjinës.
3. Një certifikatë që konfirmon pagesën e të gjitha detyrimeve të maturimit të kontratave të energjisë elektrike të operatorëve ekonomikë, regjistruar në Shqipëri. Mospagesa e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për përjashtimin e operatorëve ekonomikë, nëse rezulton që detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, siç konfirmohet nga certifikata e lëshuar nga furnizuesi, janë në procesin e ankimimit në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar të lëshojë këtë certifikatë jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së operatorëve ekonomikë.

Kriteret e përgjithshme për Pranim, nuk ndryshohen nga Autoritetet Kontraktor. Këto kritere (pikat 1, 2) vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së aplikimit.

4. Operatori ekonomik duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës shtetërorë profesionalë dhe tregtarë në vendin e themelimit, duke vërtetuar personalitetin e tij ligjor. Për këtë qëllim, kandidatët dorëzojnë një kopje të ekstraktit në lidhje me historikun e firmës, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

Një kandidat i huaj duhet të vërtetojë se ai i plotëson të gjitha kushtet e renditura më sipër. Nëse dokumentet e përmendura më sipër nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, mjafton një deklaratë me shkrim.

Dokumentet që nuk janë në gjuhën shqipe ose angleze do të pajisen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe ose angleze.



Në rast të një grupi / konsorciumi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të dorëzojë dokumentat e lartpërmendura.

Përveç kësaj, nëse aplikimi dorëzohet nga një grup / konsorcium i operatorëve ekonomikë, duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës është krijuar zyrtarisht grupi / konsorciumi i operatorëve ekonomikë;
- b. Prokurën e Posaçme.

2. Kriteret e Veçanta të Kualifikimit

1. Për të vërtetuar se operatorët ekonomikë janë të kualifikuar, aplikanti duhet të paraqesë:

- a. Deklarata për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me Shtojcën 5;
- b. Deklarata mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 6 ;
- c. Letra e aplikimit e plotësuar dhe e nënshkruar rregullisht, sipas shtojcës 1;
- d. Certifikatë e Vlefshme ISO 9001:2008;
- e. Certifikatë e Vlefshme ISO 14001:2004;
- f. Certifikatë e Vlefshme OHSAS 18001:2007;
- g. Certifikatë e Vlefshme ISO 50001:2011;
- h. Liçenca e shoqërisë e kategorive të mëposhtme

NP1 – Punime Gërmimi, Kat D

NP2 – Ndërtime Civile dhe Industriale, Kat F

NP3 – Rindërtim dhe Mirëmbajtje e ndërtesave Civile dhe Industriale, Kat C

NP4 – Rrugë, Autostrada, Ura, etj., Kat D

NS1 – Punime Prishje të Ndërtesave, Kat C

NS2 – Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre, Kat B

NS3 – Impiante lëvizjeje dhe transporti (ashensorë, shkallë, lëvizës, transportues), Kat B

NS4 – Punime murature dhe të tjera lidhur me to, strukturim me materiale druri, plastike, metalike dhe qelqi, Kat C

NS5 – Implementim i sinjaleve me ndricim të trafikut, Kat B



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

NS6 – Sinjalistikë e pa ndriçuar rrugore, Kat A

NS7 – Barriera dhe Mbrojtje Rrugore, Kat B

NS8 – Konstruksione betoni arme të parafabrikuar, struktura metalike dhe druri, Kat B

NS9 – Punime të posaçme strukturore, Kat C

NS10 – Shtresa dhe struktura të veçanta, Kat B

NS12 – Instalime teknologjike, ngrohje dhe ajër i kondicionuar, Kat D

NS13 – Implementim i linjave telefonike dhe sistemeve të telekomunikacionit, Kat C

NS14 – Instalime të brendshme, elektrike, telefon, TV, etj., Kat D

NS19 – Sisteme izoluese të zhurmës për projektet infrastrukturore, Kat B

Operatorët e huaj ekonomikë dëshmojnë se janë të kualifikuar për të marrë pjesë në oferta publike në vendet e tyre të origjinës për kategoritë e listuara më sipër.

j. Curriculum Vitae të Ekspertit të Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis i cili do të jetë i disponueshëm gjatë periudhës së ndërtimit me Licensë III.2 ose ekuivalente.

2. Për t'u kualifikuar Ofertuesi duhet të dëshmojë për Autoritetin Kontraktor se plotëson kërkesat për kapacitetet ligjore, gjendjen financiare, përvojën dhe historikun gjyqësor, të specifikuar më poshtë. Për të provuar këto kualifikime, Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Kapaciteti ligjor i operatorit ekonomik

a. Referuar Kriterëve të Përgjithshme për kualifikim

Kriteret e mësipërme përmbushen vetëm nëse dokumentet e paraqitura janë kopje origjinale apo të noterizuara. Kriteret e mësipërme duhet të vërtetohen nëpërmjet dokumenteve të lëshuara jo më parë se tre muaj nga data për hapjen e kërkesave për pjesëmarrje.

2. Kapaciteti financiar dhe ekonomik

a) Kopjet e bilanceve të audituar apo të certifikuar ose, në qoftë se nuk kërkohet nga ligjet e vendit të Ofertuesit, pasqyra të tjera financiare të pranueshme për Autoritetin Kontraktor, për pesë vitet e fundit, dhe të cilat duhet të demonstrojnë qëndrueshmërinë aktuale të aplikantit gjendjes financiare dhe të tregojnë rentabilitetin e tij të ardhshëm afatgjatë. Kur është e nevojshme, Autoriteti Kontraktor do t'i bëjë pyetje bankierëve të Ofertuesit.

b) Ofertuesi duhet të demonstrojë se ka qasje në, ose ka në dispozicion, aktive likuide, pasuri të paluajtshme të pa bllokuara, linja krediti, si dhe mjete të tjera financiare të mjaftueshme për të përmbushur fluksin monetar të ndërtimit për kontratën për një periudhë prej pesë



muajsh, vlerësuar jo më pak se 3,500,000 euro (tre milionë e pesëqind mijë), duke marrë parasysh angazhimet e aplikantit për kontratat e tjera.

3. Experienca

Në rastet kur kërkohet eksperiencë në punë apo shërbime të ngjashme, ngjashmëria do të bazohet në kompleksitetin, metodat/ teknologjinë dhe / ose karakteristika të tjera të përshkruara në fushëveprimin e projektit (*Shtojca 14, Termat e Referencës*).

Sa i përket madhësisë së punimeve ose shërbimeve, përvojë e suksesshme përbën të paktën:

- një punë ose shërbim të ngjashëm prej të paktën 50 % të vlerës së punës apo shërbimit të projektit; ose
- punë ose shërbime të ngjashme prej të paktën 200 % të vlerës së punës apo shërbimit të projektit.

Përvoja në punë apo shërbime të ngjashme do të dokumentohet duke përdorur formularin e dhënë në *Shtojcën 7, Eksperiencia e veçantë (Formulari 12)*.

Për vlerësim do të merren në konsideratë vetëm kërkesat për përvojë në punime rrugore dhe projektim, kualifikimi dhe përvoja e nënkontraktorëve të specializuar.

Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin e tij të tenderit që vërteton eksperiencën në vijim:



(i) Eksperiencë në Ndërtim

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Xhiron mesatare vjetore si kontraktori kryesor (definuar si faturim për punët në progres dhe të përfunduara) gjatë pesë viteve të fundit prej 10,000,000 Euro (dhjetë milionë), dhe

(b) Përvojë të suksesshme në ekzekutimin e

- të paktën një projekti ndërtimi në vlerën 6,300,000 (gjashtë milionë e treqind) Euro, ose
- projekte të shumta ndërtimi në vlerën 25,200,000 (njëzetë e pesë milionë e dyqind mijë) Euro,

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me punët e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktor kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor, brenda pesë viteve të fundit.

(ii) Eksperiencë në Punime Rrugore

Ofertuesi ose një nënkontraktor i specializuar do të përmbushin kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Xhiro vjetore mesatare si kontraktor i parë, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhimi ose nënkontraktor (përcaktuar si faturim për punime rrugore në proces dhe të përfunduara) në pesë vitet e fundit prej 2,700,000 (dy milionë e shtatëqind) Euro;

(b) Eksperiencë e suksesshme në kryerjen e

- të paktën një projekti ndërtimi në vlerën 700.000 (shtatëqindmijë) Euro, ose
- projekte të shumta ndërtimi në vlerën 2.800.000 (dymilion e tetëqindmijë) Euro,

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me punët e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktor kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor, brenda pesë viteve të fundit

(iii) Eksperiencë operacionale dhe mirëmbajtjeje

Ofertuesi duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme minimale:



(a) Operimin e një stacioni të transportit publik të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me projektin e propozuar, dhe

(b) Xhiro mesatare vjetore si kontraktor kryesor (përkufizuar si Paguesa totale e marrë për shërbimet e operimit dhe menaxhimit të transportit publik ose privat për shërbimet dhe eksperiencën në shkallë të gjerë të shërbimeve të mirëmbajtjes nga firma apo firmat pjesë e të cilave është Ofertuesi, pjesëtuar me numrin e viteve) gjatë pesë viteve të fundit prej 1,200,000 Euro (një milion e dyqind mijë) dhe

(c) eksperiencë të suksesshme në operimin, menaxhimin dhe mirëmbajtjen e pasurive të patundshme e

- të paktën një projekti të mirëmbajtjes me një vlerë vjetore prej 300.000 (zero pikë tre milion) Euro, ose

- projekte të shumta mirëmbajtjeje me një vlerë vjetore prej 1,200,000 (një pikë dy milion) Euro,

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktor kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor, brenda pesë viteve të fundit.

;

(iv) Eksperiencë në Projektim

Ofertuesi ose një nënkontraktor i specializuar duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme minimale:

(a) Xhiron mesatare vjetore si kontraktori kryesor, anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor (përkufizuar si faturim për punët rrugore në progres dhe të përfunduara) gjatë 5 (pesë) viteve të fundit prej 200,000 Euro (dyqind mijë);

(b) përvojë të suksesshme si Kontraktor kryesor, anëtar sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor në projektimin e

- të paktën një projekti dizanji me një vlerë 175,000 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) Euro; ose

- projekte të shumta dizanji (prjektimi) me një vlerë 700,000 (shtatëqind mijë) Euro,

të një lloji dhe kompleksiteti të krahasueshëm me shërbimet e propozuara, me rezultate të kënaqshme dhe të përfunduara prej tij si kontraktor kryesor,



Terminali i Transportit Publik Tiranë – Njoftim i Tenderit

anëtar i një sipërmarrjeje të përbashkët, kontraktor menaxhues ose nënkontraktor, brenda pesë viteve të fundit.

4. Historiku gjyqësor

Ofertuesi duhet të dorëzojë në aplikimin e tij informacion të saktë të ndonjë çështjeje gjyqësore aktuale ose të shkuar apo procedure arbitrazhi rezultuese nga kontratat e përfunduara ose të ekzekutuara prej tij gjatë pesë viteve të fundit. Një historik i vazhdueshëm kundër Ofertuesit ose ndonjë partneri të një sipërmarrjeje të përbashkët mund të rezultojë në mospranimin e aplikimit.





Shtojca 10 Deklaratë mbi Statusin Ligjor (Formulari 3)

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në Procedurën e Konkensionit / Partneritetit Publik Privat që do të zhvillohet më datë _____ nga Autoriteti Kontraktor.

Unë, i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ operatorit ekonomik _____ deklaroj se:

operatori ekonomik _____ është dënuar për vepër penale, në përputhje me nenin 45/1 të LPP-së,

operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të prerë të gjykatës, lidhur me aktivitetin e tij profesional.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

**Shtojca 11 Kriteret e Vlerësimit****VLERESIMI I OFERTAVE**

Kriteret e vlerësimit janë si më poshtë:

| Nr. | Kriteri | Rezultati Maks. | Pragu Min/ Rezult. Kalues |
|------------|--|------------------------|----------------------------------|
| TC1 | Përputhshmëria me Kriteret Minimale Teknike | 2 | 1 |
| TC2 | Korrekhtësia teknike dhe operacionale | 34 | 20 |
| TC3 | Sistemet e informacionit | 4 | 2 |
| TC4 | Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale | 10 | |
| TC4-1 | - siguria e brendshme e zonës dhe ndërtesave | 4 | |
| TC4-2 | - teknikat inovative në fushën e kursimit të energjisë dhe pajtueshmëria me standardet mjedisore | 4 | |
| TC4-3 | - zvogëlimi i ndikimit mbi trafikun lokal gjatë aktiviteteve të ndërtimit | 2 | |
| | KRITERET TOTALE TEKNIKE | 50 | |
| FC1 | KOHËZGJATJA E KONÇESIONIT | 10 | |
| FC2 | TARIFA E KONÇESIONIT | 10 | |
| FC3 | TARIFAT E TERMINALIT | 10 | |
| FC4 | NDARJA E FITIMIT | 10 | |
| | KRITERET TOTALE FINANCIARE | 40 | |
| CTC1 | AFATI I NDËRTIMIT | 10 | |
| | TOTALI | 100 | |



KRITERET TEKNIKE

Kriteret e vlerësimit teknik, duke përfshirë rezultatet dhe pragjet minimale / rezultatet kaluese (kur është e përshtatshme) përshkruhen më poshtë. Vlerësimi do të kryhet nga Komiteti i Vlerësimit, i asistuar nga ekspertë specifikë për fushat kyçe, dhe do të marrë në konsideratë elementët e përshkruar më poshtë.

TC1: Pajtuëshmëria me Kushtet Minimale Teknike - 2 pikë (pragu minimal / rezultat kalues - 1 pikë).

Çdo Ofertues duhet të respektojë kufizimet minimale teknike të përcaktuara në ***Kriteret Minimale Teknike (Shtojca 13 Specifikimet Teknike)***. Koncepti kryesor që do të mbahet është që këto propozime të cilat nuk përputhen me këto kërkesa themelore do të skualifikohen.

TC2: Korrektësia teknike dhe operationale - 34 pikë (pragu minimal / rezultat kalues- 20 pikë).

Korrektësia teknike dhe operationale do të vlerësohet në bazë të dizenjës së projektit, planit të biznesit, afatit të realizimit dhe cilësisë së shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre.

Dizajni i Projektit – përshtatshmëria e arranzhimeve të projektit dhe karakteristikave të tij, cilësia e Raportit të Dizajnit Paraprak, kriteret e cilësisë që do të zbatohen.

Dizajni i Projektit duhet të përmbajë një ***Raport Dizajni Paraprak*** dhe një ***Raport mbi Efikasitetin Operacional***;

Raporti i Dizajnit Paraprak duhet të japë një përshkrim të përgjithshëm teknik të ndërtimit dhe instalimeve dhe të përfshijë detaje mbi

- Përshkrimin dhe specifikimin e materialeve që do të përdoren për të përfunduar ndërtesat dhe zonat e terminalit
- Instalimet për të rritur komoditetin e udhëtarëve si shkallë dhe ashensorë;
- Sistemet e propozuara të informacionit, për shembull për pagesat, sistemet e njohjes së numrit të kompjuterizuar të targave, sistemet për caktimin e automjeteve në hyrje për të arritur përdorimin më të mirë të vendeve të parkimit, sistemet për monitorimin e flukseve të trafikut dhe okupimin e vendeve të parkimit;
- Teknikat dhe zgjidhjet novatore për sistemin e ndriçimit (si të zakonshëm ashtu edhe për emergjencat) do të vlerësohen mbi bazën e qëndrueshmërisë së tyre teknike, plotësisë së mbulimit të propozuar brenda terminalit, konsumin e tyre të energjisë, rritjes së nivelit të sigurisë në lidhje me ndriçimin në raste emergjente, zbatimin e zgjidhjeve backup, zgjidhjet anti-panik në zonat me rrezik të lartë;



Raporti mbi Eficencën Operacionale duhet të japë një përshkrim të përgjithshëm të operacioneve dhe të përfshijë detaje për:

- Mekanizmin e Pagesave dhe propozimet mbi integrimin e faturimit të biletave për shërbime të ndryshme;
- Përmbajtja e Raporteve Mujore Operacionale që do ti dorëzohen Bashkisë së Tiranës;

Plani i Biznesit – Analiza e Kostos dhe e të Ardhurave dhe Vlerësimi i Kostove të Përsëritura, duke përfshirë një Plan Investimi, Deklaratën Fitim & Humbje, Pasqyrën e Fluksit të Parasë dhe analizën e ndjeshmërisë.

Programi i Zbatimit –Koha e lejuar për kontrollet në terren, projektin e detajuar, ekzekutimin e projektit të ndërtimit, duke përfshirë prodhimin, shpërndarjen dhe instalimin e pajisjeve teknike. Gjatësia e periudhës së ndërtimit dhe koha për fillimin e funksionimit të terminalit duhet të jetë në përputhje me periudhën e ofruar në ofertën financiare.

Cilësia e shërbimeve dhe masave për të siguruar vazhdimësinë e tyre - Ofertuesit duhet të dorëzojnë programet e Mirëmbajtjes së tyre Kryesore dhe të Mirëmbajtjes Specifike për instalimet e ndërtesave dhe ato teknike, si dhe të masave të tjera për të siguruar funksionimin e mirë të objekteve deri në skadimin e periudhës së Koncensionit. Raporti mbi cilësinë e shërbimeve duhet të tregojë disponueshmërinë e tyre të garantuar dhe treguesit relativë të performancës;

TC3: Sistemet e Informacionit - 4 pikë (pragu minimal/ rezultat kalues - 2 pikë).

Sistemet informative për udhëtarët në mbërritjen dhe nisjen e autobusëve dhe tramvajëve / trenave dhe për përdoruesit e vendit të parkimit në lidhje me disponueshmërinë dhe aksesin në parkim do të vlerësohen mbi bazën e qëndrueshmërisë së tyre teknike, plotësinë e informacionit të propozuar, përhapjen e paneleve informative brenda terminalit dhe disponueshmërinë e informacionit nëpërmjet internetit.

TC4: Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale - 10 pikë(nuk ka prag minimal/ rezultat kalues).

Pranueshmëria Mjedisore dhe Sociale do të vlerësohet duke marrë në konsideratë:

- sigurinë e brendshme të zonës dhe ndërtesave përmes një propozimi që ofron sisteme të tilla si kontroll të hyrjes, kamera, mundësinë për të përdorur telefonat celularë në çdo vend brenda terminalit, shërbimet e sigurisë (numrin e personave, turnet), etj (TC4-1 rezultati maksimal 4 pikë)
- teknika inovative në fushën e kursimit të energjisë dhe pajtueshmëri me standardet mjedisore (TC4-2 rezultati maksimal 4 pikë)



- propozimin për të reduktuar, gjatë aktiviteteve ndërtimore, përfshirjen e rrugëve të zakonshme dhe ndikimin në trafikun lokal (TC4-3 rezultati maksimal 2 pikë)

$$TC4_i = TC4-1_i + TC4-2_i + TC4-3_i$$

TC: Rezultati Teknik – maksimumi 50 pikë

$$TC_i = TC1_i + TC2_i + TC3_i + TC4_i$$

KRITERET FINANCIARE

FC1: Kohëzgjatja e Periudhës së Konkensionit – maksimumi 10 pikë

Rezultati për Kohëzgjatjen e Periudhës së Konkensionit (maksimumi 35 vjet, minimum 15 vjet) llogaritet si vijon:

$$FC1_i = 10 \times CP_{\min}/CP_i$$

ku:

$$FC1_i = \text{Pikët totale të Periudhës së Konkensionit për Propozimin (i)}$$

$$CP_i = \text{Periudha e Konkensionit në Propozim (i) (muaj)}$$

$$CP_{\min} = \text{Periudha Minimale e Konkensionit në të gjithë Propozimet (muaj)}$$

Ku Periudha e Konkensionit e ofruar nga Ofertuesi është më pak se 180 muaj (15 vjet), CP_i do të jetë e njëjtë më 180 dhe rrjedhimisht edhe CP_{\min} është e barabartë me 180.

Ku Periudha e ofruar e Konkensionit tejkalon 420 muaj (35 vjet), oferta do të përjashtohet si jo-e përgjegjshme.

Periudha e Konkensionit ka kuptimin e përcaktuar në nenin 2.2 (a) të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

FC2: Tarifa e Konkensionit – maksimumi 10 pikë

Çdo vit gjatë Fazës Operacionale, Partneri Privat do të sigurojë falas Autoritetin Kontraktor me të paktën një për qind (1%) të të ardhurave bruto vjetore, në mënyrë të detajuar në nenin 16.1 të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat ("Tarifa e Konkensionit").

Ofertuesit duhet të japin ofertën e tyre të barabartë, ose mbi këtë përqindje prej 1% të të ardhurave bruto vjetore.

$$FC2_i = 10 \times [(CF_i - 1\%) / (CF_{\max} - 1\%)]$$



ku:

$FC2_i$ = Rezultati i Tarifës së Konkensionit për Ofertuesin (i)

CF_i = Tarifa e Konkensionit të propozuar nga Ofertuesi (i) (në %)

CF_{max} = Tarifa më e lartë e Konkensionit e ofruar midis të gjithë ofertave (në %)

FC3: Tarifat e Terminalit – maksimumi 10 pikë

Sipas paragrafit 15.1 të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, Partneri Privat ka të drejtë të vjelë Tarifat e Terminalit për Përdoruesit e Terminalit dhe ti mbajë ato gjatë Periudhës së Konkensionit, në përputhje me Skedulën 3 (*Tarifat e Terminalit*) të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

Ofertuesi duhet të ofrojë një zbritje të vetme për të aplikuar për të gjitha tarifat e terminalit të dhëna në Skedulën 3 (*Tarifat e Terminalit*) të Draft Kontratës së Konkensionit/ Partneritetit Publik Privat.

$$FC3_i = 10 \times CH_i / CH_{max}$$

ku:

$FC3_i$ = rezultati i Tarifave të Terminalit për Ofertuesin (i)

CH_i = zbritja në Tarifat e Terminalit të propozuara nga Ofertuesi (I) (në%)

CH_{max} = zbritja më e lartë në Tarifat e Terminalit të ofruara ndërmjet të gjithë ofertuesve (në%)

FC4: Ndarja e fitimit – maksimumi 10 pikë

Partneri Privat siguron Autoritetin Kontraktor me një përqindje të të ardhurave vjetore bruto.

Ofertuesit duhet të sigurojnë këtë përqindje të ndarjes së fitimit mbi të ardhurat bruto sic specifikohet në Klauzolën 13.3 të Draft Kontratës së Konkensionit/ Partneritetit Publik Privat.

$$FC4_i = 10 \times MRG_{min} / MRG_i$$

ku:

$FC4_i$ = Rezultati i Ndarjes së Fitimit për Ofertuesin (i)

MRG_i = Ndarja e fitimit e propozuar nga Ofertuesi (i) (në %)

MRG_{min} = Ndarja më e lartë e fitimit e propozuar ndërmjet të gjithë ofertuesve (në %).



FC: Rezultati Financiar – maksimumi 40 pikë

$$FC_i = FC_{1i} + FC_{2i} + FC_{3i} + FC_{4i}$$

AFATI I NDËRTIMIT

CTC1: Afati i Ndërtimit – maksimumi 10 pikë

Ofertuesit duhet të tregojnë kohën e ndërtimit (në ditë) të nevojshme nga "Data Efektive" e Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat (siç përcaktohet në Klauzolën 3.5 të Draft Kontratës së Konkensionit/Partneritetit Publik Privat, deri në "Datën e Hapjes së Terminalit", ku kjo e fundit nënkupton datën në të cilën Terminali hapet për përdoruesit e Terminalit me objektet operative të zbatueshme në përputhje me Kontratën e Konkensionit/Partneritetit Publik Privat.

$$CTC_i = 10 \times CT_{\min} / CT_i$$

ku:

CTC_i = Pikët totale për Afatin e Ndërtimit (i)

CT_i = Afati i Ndërtimit në propozim (i) (ditë)

CT_{\min} = Afati më i ulët i ndërtimit në të gjithë propozimet (ditë)

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM

$$\text{Pikët totale}_i = TC_i + FC_i + CTC_i$$



Shtojca 12 Vetë Deklarimet e Ofertuesve të Huaj (Formulari 16)

[Shtojcë për t'u dorëzuar nga operatori ekonomik]

Për të marrë pjesë në procedurën për marrjen e Koncesionit / Partneritetit Publik Privat për "Projektimin, Ndërtimin, Financimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Transferimin e Terminalit të Transportit Publik të Tiranës"

Për:

[Datë]

[Emri i Ofertuesve/Anëtari Udhëheqës i Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve] deklaroj dhe garantoj në datën e këtij dokumenti se [Emri i Ofertuesve/Anëtari Udhëheqës i Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve] dhe secili prej anëtarëve të Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve (nëse zbatohet)

- (a) nuk është subjekt i procedurave të falimentimit apo likuidimit;
- (b) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale;
- (c) nuk është dënuar me vendim të prerë të gjykatës, lidhur me aktivitetin e tij profesional;
- (d) kapitalet/asetet nuk janë vlerësuar nga Zyra e Përmbarimit apo nuk ekziston një urdhër sekuestroje për to.;
- (e) ka plotësuar të gjitha detyrimet fiskale;
- (f) ka plotësuar të gjitha detyrimet e sigurimit shoqërore.

Me respekt,

Nënshkrimi i Personit të Autorizuar

Emri dhe funksionet e nënshkruesve

Emri i Ofertuesve / Udhëheqësi i Bashkimit të Përkohshëm të Operatorëve

Adresa



Shtojca 13 Specifikimet Teknike

KRITERET TEKNIKE MINIMALE

1. Hyrje

Projekti i Terminalit duhet të përgatisë Zhvillimin e Projektit, me referencë ndaj **Zgjidhjes 3**, dhe duhet të garantojë funksionalitetin e plotë të Terminalit nëpërmjet vetëm ndërtimit dhe aktivizimit të godinave dhe ambienteve të mëposhtme :

- a) Hyrjes në Terminal me sheshrrotullim në SH1 (Rruga Kastrioti);
- b) Rrugët qarkulluese të Terminalit me zbritje dhe marrje të pasagjerëve;
- c) Parkingun e autobusëve, furgona-taksi dhe taksive;
- d) Godinave të udhëtarëve;
- e) Urave të këmbësorëve;
- f) Garazhit të autobusëve dhe stacionit të shërbimit të karburantit;
- g) Hapësirës publike;
- h) Lehtësimit mjedisor.

Një listë e plotë e të gjitha përdorimeve që ofrohen në godinat e mëparshme jepet në Detyrën 4 të Përshkrimit të Projektit, gjithashtu duke iu referuar dimensioneve dhe funksioneve të godinave, e cila do të konfirmohet nga Koncesionari në projektimin e Terminalit.

2. Kriteret e përgjithshme të projektimit

Projekti i Terminalit duhet të përgatisë Përshkrimin e Projektit, me referencë të veçantë ndaj Detyrës 4, dhe duhet të konfirmojë konceptin e projektit, planin horizontal të projektit, organizimin funksional, dimensionimin, kombinimin funksional dhe sipërfaqet, aksesueshmërinë e automjeteve, rregullimin plano-altimetrikë shërbimeve, rrugët e këmbësorëve dhe pistat e automjeteve.

Projektimi i Terminalit duhet të jetë në përputhje me kodet dhe/ose rregulloret kombëtare dhe kodet Europiane, gjithashtu sipas standardeve ndërkombëtare, veçanërisht për personat me lëvizshmëri të kufizuar (2008/164/EC: Vendim i Komisionit i datës 21 dhjetor 2007 në lidhje me specifikimin teknik të ndëroperueshmërisë në lidhje me personat me lëvizshmëri të kufizuar në sistemin hekurudhor konvencional dhe ekspres trans-europian, të njoftuar sipas dokumentit C(2007) 6633).

Koncesionari duhet të garantojë mundësinë e realizimit të një rruge të re hyrëse për në Terminal.

3. Kriteret e Projektimit për Godinat e udhëtarëve, Urat e Këmbësorëve.

Tipi dhe dimensionimi i elementëve të disa godinave (shkallët dhe parrmakët, platformat hidraulike, shkallët lëvizëse, ashensorët, rrugët pa pengesa, dyert dhe



hyrjet, tualetet, gjeometria e urave të këmbësorëve, daljet në raste emergjencash, informacioni vizual si sinjal drejtues, piktogramat dhe informacioni dinamik, ndriçimi, sipërfaqet e dysHEMEVE, ambientet e parkimit për PRM-në, pengesat transparente etj) do të duhet të jenë në përputhje me kodet europiane(2008/164/EC).

Pozicionet dhe madhësitë e godinave duhet të jenë ato të përfaqësuara në Përshkrimin e Projektit- Detyra 4.

3.1 Çështjet strukturore

Projektimi strukturor i të gjithë Terminalit duhet të respektojë udhëzimet e Kodeve Europiane si dhe të kodeve lokale, ku të dyja synohen të jenë standarde referuese.

Përveç kësaj, projektimi strukturor duhet të përmbushë kërkesat e madhësisë dhe formës të përcaktuara nga koncepti arkitekturor.

Si rrjedhojë, përdorimi i një strukture çeliku ofron më shumë hapësira dhe përshtatshmëri më të madhe në lidhje me veshjen e mureve dhe çatisë.

Gjithashtu, shpejtësia e ndërtimit, kostot e parashikueshme të mirëmbajtjes së bashku me pesha më të ulëta dhe thellësinë e ndërtimeve janë arsye të vlefshme përse struktura e çelikut është zgjidhja më e përshtatshme.

Rrjedhimisht, dyshemetë e godinave dhe platformat e urave të këmbësorëve duhet të përbëhen nga traversa të përbëra çeliku dhe pllakë hekur-betoni ndërsa themelet duhet të jenë prej betoni.

Sistemet e trajtimit mbrojtës duhet të aplikohen për kuadrot strukturore të çelikut, duke përdorur një kombinim të lyerjes, spërkatjen ose galvanizimin e metalit, në varësi të kushteve mjedisore dhe lehtësisë të mirëmbajtjes së ardhshme.

